



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.45**

**30 prill**

**2012**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr. 46/2012  
datë 26.4.2012

Për ratifikimin e marrëveshjes së huas A ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KFW Frankfurt am Main për financimin e programit “Infrastruktura bashkiake II, furnizimi me ujë dhe kanalizimet për qytetet Berat, Fier, Kamzë, Kuçovë, Lushnjë dhe Sarandë”.....

2375

Ligj nr. 47/2012  
datë 26.4.2012

Për ratifikimin e marrëveshjes së huas B ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KFW Frankfurt am Main për financimin e programit “Infrastruktura bashkiake II, furnizimi me ujë dhe kanalizimet për qytetet Berat, Fier, Kamzë, Kuçovë, Lushnjë dhe Sarandë”.....

2413

**LIGJ**  
**Nr. 46/2012**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS A NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCEVE, DHE KFW FRANKFURT AM MAIN PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT “INFRASTRUKTURA BASHKIAKE II, FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIMET PËR QYTETET BERAT, FIER, KAMZË, KUÇOVË, LUSHNJË DHE SARANDË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja e huas A ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e programit “Infrastruktura bashkiake II, furnizimi me ujë dhe kanalizimet për qytetet Berat, Fier, Kamzë, Kuçovë, Lushnjë dhe Sarandë”.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 26.4.2012

**Shpallur me dekretin nr.7427, datë 30.4.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**MARRËVESHJE HUAJE A**

**DATË 20 MARS 2012 NDËRMJET KFW-SË, FRANKFURT MBI MAIN (KFW) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCEVE, TIRANË (HUAMARRËSI) PËR 12 000 000 EURO**

**PROGRAMI II I INFRASTRUKTURËS BASHKIAKE  
FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIMET PËR QYTETET E  
BERATIT, FIERIT, KAMZËS, KUÇOVËS, LUSHNJËS DHE SARANDËS  
(PROGRAMI)**

**Preambulë**

Baza për këtë marrëveshje huaje A është marrëveshja e datës 11 maj 2011 ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë mbi “Bashkëpunimin financiar 2008, 2010 për programin ii të infrastrukturës bashkiake”



(Marrëveshje qeveritare). Një hua tjetër në shumën prej 2 milionë euro (huaja B) dhe një kontribut financiar i dhënë nga Bashkimi Europian në shumën prej 20 482 000 euro (Kontributi financiar) do të jepet nga KfW-ja në pajtim me një marrëveshje huaje (marrëveshja e huas B) dhe një marrëveshje financiare (marrëveshja financiare) ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit:

Me kushtin që Republika Federale Gjermane të japë subvencione për normën e interesit dhe me kushtin që Republika Federale Gjermane të japë një garanci për huan, KfW-ja do të japë një hua në pajtim me termat dhe dispozitat e kësaj marrëveshjeje huaje A. Termat dhe kushtet e huas A përputhen me kërkesat e OECD-së të zbatueshme në datën e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje huaje A për njohjen si Asistencë Zyrtare për Zhvillimin (ODA).

#### 1. Huaja

1.1 *Shuma*. KfW-ja do t'i japë Huamarrësit një hua që nuk kalon një total prej 12 000 000 euro (në fjalë: dymbëdhjetë milionë euro) (Huaja A).

1.2 *Qëllimi i huas*. Huamarrësi e kanalizon huanë A plotësisht te shoqëritë UK Berat Kuçovë, UK Fier, UK Lushnjë, UK Saranda dhe te departamenti i ujit të bashkisë së Kamzës (së bashku “Agjencitë e zbatimit të projektit”, secila një “Agjenci e zbatimit të projektit”), në pajtim me kushtet e parashikuara në nenin 2. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit do të veprojë si njësi e zbatimit të projektit (njësi e zbatimit të programit) për konsulentin e zbatimit. Huamarrësi merr masa që çdo agjenci e zbatimit të projektit të përdorë huan A vetëm për financimin e investimeve për përmirësimin e furnizimit me ujë dhe sistemet e kanalizimeve në qytetet e Beratit, Fierit, Kamzës, Kuçovës, Lushnjës dhe Sarandës (secili një “nënprojekt”, së bashku “Programi”), përkatësisht dhe kryesisht për të paguar koston e shkëmbimit të huaj. Njësia e zbatimit të programit, agjencitë e zbatimit të projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë hollësitë e programit, si dhe mallrat dhe shërbimet që duhet të financohen nga huaja A në një marrëveshje të veçantë, e cila duhet të miratohet nga Huamarrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave.

1.3 *Tatimet, taksat, detyrimet doganore*. Tatimet dhe taksat e tjera publike për të cilat detyrohet Huamarrësi, njësia e zbatimit të programit dhe secila prej agjencive të zbatimit të projektit, si dhe detyrimet doganore nuk mund të financohen nga huaja A.

#### 2. Kanalizimi i huas A tek agjencitë e zbatimit të projektit

2.1 *Marrëveshja e nënhuas*. Përveç kur bihet dakord ndryshe sipas një politike të re të Qeverisë së Shqipërisë, me pëlqimin paraprak të KfW-së, Huamarrësi e kanalizon huanë A të përcaktuar në euro tek agjencitë e zbatimit të projektit sipas marrëveshjeve të nënhuas për një afat prej 40 vjetësh duke përfshirë një periudhë pa pagesa prej 10 vjetësh, duke filluar nga 20 marsi 2012. Interesi nuk kalon shumën totale të interesit që rrjedh nga neni 5.1.

2.2 *Përkthimi i certifikuar*. Para disbursimit të parë nga huaja A, Huamarrësi i dërgon KfW-së një përkthim të certifikuar në anglisht ose gjermanisht të secilës prej marrëveshjeve të nënhuas të specifikuar në nenin 2.1.

2.3 *Mungesa e përgjegjësisë së agjencisë së zbatimit të projektit*. Kanalizimi i huas A nuk përbën përgjegjësi të ndonjë agjencie të zbatimit të projektit kundrejt KfW-së për detyrimet e pagesës sipas marrëveshjes së huas A.

#### 3. Disbursimi

3.1 *Kërkesa për disbursim*. Sapo të përmbushen të gjitha kushtet paraprake për disbursimin në pajtim me nenin 3.3, KfW-ja disburson huan A në pajtim me progresin e programit me kërkesë të Huamarrësit. Disbursimi realizohet në pajtim me grafikun e disbursimit që gjendet në aneksin 1 të kësaj marrëveshjeje huaje A. KfW-ja bën disbursime vetëm deri në shumat maksimale të përcaktuara për çdo gjashtëmujor. Në masën që Huamarrësi kërkon disbursimin e shumave të vogla brenda një gjysmë viti, shumat e padisbursuara mund të kërkohen në çdo periudhë pasuese gjashtëvjetore. Me përjashtim të disbursimit të fundit, KfW-ja nuk është e detyruar të realizojë disbursime në një shumë më të vogël se 1 000 000 euro.

3.2 *Afati për kërkimin e disbursimit.* KfW-ja mund të refuzojë disbursimet pas datës 31 dhjetor 2015. Me kërkesë të Huamarrësit, ky afat mund të shtyhet në pajtim me aprovimin e KfW-së.

3.3 Kushtet paraprake për disbursimin. KfW-ja është e detyruar të bëjë disbursimet e çdo shume sipas kësaj marrëveshjeje huaje A vetëm me përmbushjen e kushteve të mëposhtme paraprake në formën dhe përmbajtjen e pranueshme për KfW-në:

a) Huamarrësi ka demonstruar duke paraqitur një opinion ligjor me përmbajtje sipas parashikimit në aneksin 2 dhe duke paraqitur kopje të certifikuara (secila me një përkthim në gjermanisht ose anglisht) të të gjithë dokumenteve të cilave u referohet opinionin ligjor që:

aa) Huamarrësi ka përmbushur të gjitha kërkesat sipas ligjit të vet kushtetues dhe dispozitave të tjera ligjore për marrjen përsipër në mënyrë të vlefshme të të gjitha detyrimeve të tij sipas kësaj marrëveshjeje huaje A; dhe

bb) KfW-ja përjashtohet nga të gjitha tatimet mbi të ardhurat nga interesat, detyrimet, tarifrat dhe kostot e ngjashme në Shqipëri kur jep huanë A;

b) ekzemplarët e nënshkrimeve të përmendura në nenin 13.1 (përfaqësimi i Huamarrësit) janë paraqitur;

c) Garancia nga Republika Federale Gjermane e përmendur në nenin 8 është në fuqi pa kufizim;

d) Huamarrësi ka paguar tarifën e menaxhimit të përmendur në nenin 4.2;

e) nuk ka ndodhur ose nuk rrezikon të ndodhë asnjë shkak për zgjidhje marrëveshjeje; dhe

f) nuk kanë lindur rrethana të jashtëzakonshme që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin, ose qëllimin e programit, ose përmbushjen e detyrimeve të pagesës të marra përsipër nga Huamarrësi sipas marrëveshjes së huas A.

Para disbursimit nga huaja A, KfW-ja ka të drejtën për të kërkuar dokumente dhe prova të tjera që konsiderohen të nevojshme për të vlerësuar përmbushjen e kushteve paraprake.

3.4 *Marrëveshje e veçantë.* Në një marrëveshje të veçantë që duhet të bihet dakord ndërmjet Huamarrësit, përfaqësuar nga Ministria e Financave, njësia e zbatimit të programit, agjencitë e zbatimit të projektit dhe KfW-ja specifikojnë procedurën e disbursimit duke përfshirë kushte specifike paraprake për disbursimin dhe veçanërisht provat që duhet të paraqiten nga njësia e zbatimit të programit dhe/ose agjencitë e zbatimit të projektit që provojnë se shumtë e kërkuara të huas përdoren për qëllimin e parashikuar në këtë marrëveshje huaje A. Agjencitë e zbatimit të projektit duhet të demonstrojnë para çdo disbursimi, duke paraqitur të gjitha dokumentet e kërkuara që kërkesat e përcaktuara në Marrëveshjen e veçantë (marrëveshjet e veçanta të zbatimit) janë përmbushur.

3.5 *Heqja dorë nga disbursimi.* Në pajtim me përmbushjen e detyrimeve të veta dhe detyrimeve të Agjencive të Zbatimit të Projektit përkatësisht sipas nenit 11, Huamarrësi mund të heqë dorë nga disbursimi i shumave të padisbursuara të huas me pëlqimin e KfW-së në këmbim të pagesës së kompensimit të mospranimit në pajtim me nenin 3.6.

3.6 *Kompensimi i mospranimit.* Nëse Huamarrësi heq dorë nga disbursimi i një shume të Huas, ose nëse një shumë huaje nuk disbursohet fare ose nuk disbursohet në afatin e caktuar në nenin 3.2 për shkaqe të tjera për të cilat nuk mund të bëhet përgjegjëse KfW-ja, Huamarrësi, jo më vonë se 10 ditë bankare (sipas përcaktimit në nenin 14.1) pas kërkesës së parë i paguan KfW-së me kërkesën e saj atë shumë që është normalisht e nevojshme për të kompensuar KfW-në për çdo humbje, shpenzim, kosto të pësuar nga KfW-ja si rezultat i mospranimit të shumës së huas në fjalë krahasuar me mundësitë e riinvestimit. KfW-ja llogarit shumën e kompensimit të mospranimit dhe ia komunikon atë Huamarrësit.

#### 4. Tarifrat

4.1 *Tarifa e zotimit financiar.* Huamarrësi paguan një tarifë zotimi financiar të pakthyeshme prej 0.25% p.a. (me fjalë: zero pikë dy pesë për qind në vit) për shumtë e padisbursuara të huas.



*Tarifa e zotimit financiar* llogaritet për periudhën që fillon me kalimin e një afati tremujor pas nënshkrimit të marrëveshjes së huas A dhe që zgjat deri në atë datë kur huaja A të jetë disbursuar plotësisht, ose anuluar plotësisht, sipas rastit.

Tarifa e zotimit financiar bëhet e kërkueshme për pagesë çdo gjysmë viti në fund të periudhës më 30 qershor dhe 30 dhjetor të çdo viti (secila “data e pagesës”). Së pari është e kërkueshme për pagesë më 30 qershor 2012, por jo më parë se data e pagesës, pas datës në të cilën hyn në fuqi kjo marrëveshje huaje në pajtim me nenin 14.11.

4.2 *Tarifa e menaxhimit*. Huamarrësi i paguan KfW-së një shumë të përgjithshme të njëhershme dhe të pakthyeshme si tarifë menaxhimi që është e barabartë me 1.0% (në fjalë një pikë zero për qind) të shumës principale të huas A të përcaktuar në nenin 1.1 jo më vonë se pas kalimit të një periudhe prej tre muajsh pasi të jetë nënshkruar kjo marrëveshje huaje A nga KfW-ja ose jo më vonë se pas kalimit të një periudhe njëmuajore pasi të ketë hyrë në fuqi kjo marrëveshje huaje A (në varësi se cila është data më e mëvonshme), por në çdo rast para disbursimit të parë nga huaja A.

## 5. Interesi

Huamarrësi i paguan KfW-së një interes në normën e caktuar si më poshtë:

5.1 *Interesi (normë fikse interes që caktohet me dhënien e huas A)*. Huamarrësi paguan një interes për huanë A me normën e \_\_\_\_\_% (siç llogaritet një ditë bankare pas ratifikimit) p. a (në fjalë: \_\_\_\_\_ për qind në vit) (Norma fikse e interesit) deri sa të jetë marrë shlyerja e kështit të fundit në pajtim me grafikun e shlyerjes sipas përcaktimit në nenin 6.1.

5.2 *Llogaritja e interesit dhe datat e pagesës së interesit*. Interesi për një shumë të disbursuar të huas do të përlllogaritet nga data (duke përjashtuar atë) në të cilën paguhet shuma përkatëse e huas nga llogaria e huas që mbahet tek KfW-ja për Huamarrësin deri në datën (duke e përfshirë atë), në të cilën shlyerjet përkatëse kreditohen tek llogaria e KfW-së e përcaktuar në nenin 7.3. Interesi do të llogaritet në pajtim me nenin 7.1 (*llogaritja*). Interesi paguhet në fund të periudhës në datat e pagesës (sipas përcaktimit në nenin 4.1).

## 6. Shlyerja dhe parapagimi

6.1 *Grafiku i shlyerjes*. Huamarrësi e shlyen huanë A si më poshtë:

Kësti	Data		Shuma	
1	30 qershor	2015	500 000,00	euro
2	30 dhjetor	2015	500 000,00	euro
3	30 qershor	2016	500 000,00	euro
4	30 dhjetor	2016	500 000,00	euro
5	30 qershor	2017	500 000,00	euro
6	30 dhjetor	2017	500 000,00	euro
7	30 qershor	2018	500 000,00	euro
8	30 dhjetor	2018	500 000,00	euro
9	30 qershor	2019	500 000,00	euro
10	30 dhjetor	2019	500 000,00	euro
11	30 qershor	2020	500 000,00	euro
12	30 dhjetor	2020	500 000,00	euro
13	30 qershor	2021	500 000,00	euro
14	30 dhjetor	2021	500 000,00	euro
15	30 qershor	2022	500 000,00	euro
16	30 dhjetor	2022	500 000,00	euro
17	30 qershor	2023	500 000,00	euro
18	30 dhjetor	2023	500 000,00	euro
19	30 qershor	2024	500 000,00	euro
20	30 dhjetor	2024	500 000,00	euro

21	30 qershor	2025	500 000,00	euro
22	30 dhjetor	2025	500 000,00	euro
23	30 qershor	2026	500 000,00	euro
24	30 dhjetor	2026	500 000,00	euro

6.2 *Shumat e padisbursuara të huas*. Shumat e padisbursuara të huas do të kompensohen kundrejt shlyerjes së kështit të fundit përkatës të kërkueshëm, në pajtim me grafikun e shlyerjes, përveç kur KfW-ja, në tagrin e saj, zgjedh një kompensim tjetër në raste individuale pas njoftimit të bërë më parë ndaj Huamarrësit.

6.3 *Disbursimet pas fillimit të shlyerjes*. Nëse shumat e huas disbursohen pasi të ketë filluar shlyerja, grafiku i shlyerjes siç renditet në nenin 6.1 mbetet i paprekur sa kohë që shlyerja e kështit përkatës të kërkueshëm, në pajtim me grafikun e shlyerjes, është më i vogël se shumat e huas të disbursuara. Nëse kështi i kërkueshëm i shlyerjes e kalon shumën e pashlyer të huas, KfW-ja zbret shumën e barabartë me diferencën nga shlyerja e kështit të kërkueshëm, e ndan atë me mbetjen e kësteve të papaguara dhe ia shton këtë shumë çdo shlyerjeje të kësteve të papaguara. KfW-ja rezervon të drejtën të shtyjë marrjen në konsideratë të shlyerjeve të bëra brenda 45 ditëve para datës përkatëse të pagesës për përcaktimin e shumës së pashlyer të huas deri në datën e dytë të pagesës pas disbursimit.

6.4 *Parapagimi*. Sa më poshtë zbatohet për shlyerjet e parakohshme:

a) *E drejta për të bërë pagesa të parakohshme*. Huamarrësi, në pajtim me nënparagrafët e mëposhtëm (b) dhe (e), mund të kryejë shlyerje të parakohshme në lidhje me një shumë huaje, me kusht që kjo shlyerje e parakohshme të jetë të paktën sa shuma e një shlyerjeje kështi në pajtim me nenin 6.1.

b) *Njoftimi*. Një pagesë e parakohshme e shumës së huas në pajtim me nenin 6.4 a) i nënshtrohet njoftimit të pagesës së parakohshme nga huamarrësi për KfW-në jo më vonë se dita e pesëmbëdhjetë bankare në Frankfurt mbi Main para datës së synuar për pagesën e parakohshme. Ky njoftim është i parevokueshëm; ai duhet të specifikojë datën në të cilën duhet të bëhet shlyerja e parakohshme dhe shuma e saj dhe e detyron Huamarrësin t'i paguajë KfW-së shumën e përcaktuar në datën e caktuar.

c) *Kompensimi i pagesës së parakohshme*. Nëse Huamarrësi shlyen para kohe një shumë huaje që ka një interes me një normë fikse interesi, Huamarrësi, brenda 10 ditëve bankare, i paguan KfW-së me kërkesë atë shumë që është e nevojshme për të kompensuar një dëm, shpenzim ose kosto të pësuar nga KfW-ja si rezultat i shlyerjes së parakohshme. KfW-ja përcakton shumën e kompensimit të shlyerjes së parakohshme dhe ia komunikon atë Huamarrësit.

d) *Shumat e kërkueshme*. Huamarrësi paguan gjithashtu shumat e mëposhtme së bashku me shlyerjen e parakohshme, në pajtim me nenin 6.4 a) deri c):

aa) çdo kompensim të shlyerjes së parakohshme të kërkueshëm si rezultat i shlyerjes së parakohshme në pajtim me nenin 6.4 c); dhe

bb) të gjithë interesin e mbledhur për shumën e shlyer para kohe të huas deri në datën e shlyerjes së parakohshme.

e) *Kompensimi*. Neni 6.2 (*shumat e padisbursuara të huas*) zbatohen *mutatis mutandis* për kompensimin e shlyerjeve të parakohshme.

6.5 *Grafiku i rishikuar i shlyerjes*. Në rast se zbatohet neni 6.3 (*disbursimet pas fillimit të shlyerjes*) ose neni 6.4 (*shlyerja e parakohshme*), KfW-ja i dërgon Huamarrësit një grafik të rishikuar të shlyerjes që bëhet pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje huaje A dhe e zëvendëson grafikun e shlyerjes të vlefshëm deri në atë datë.

7. Llogaritjet dhe pagesat në përgjithësi

7.1 *Llogaritja*. Interesi, tarifa e zotimit financiar, kamatëvonesa në pajtim me nenin 7.5, kompensimi si shumë e plotë për shumat e vonuara në pajtim me nenin 7.6, kompensimi i



mospranimit dhe kompensimi i shlyerjes së parakohshme do të llogariten të gjitha mbi bazën e një viti me 360 ditë dhe muaj me 30 ditë.

7.2 *Data e kërkueshme*. Nëse pagesa që bëhet në lidhje me këtë marrëveshje huaje A bie në një datë që nuk është ditë bankare, Huamarrësi duhet ta kryejë këtë pagesë në ditën pasuese bankare. Nëse dita pasuese bankare bie brenda muajit pasues kalendarik, pagesa përkatëse kryhet në ditën e fundit bankare të muajit përkatës kalendarik.

7.3 *Numri i llogarisë, koha e kreditimit*. Huamarrësi lirohet nga detyrimet e pagesës në lidhje me këtë marrëveshje huaje A, nëse dhe menjëherë sapo të jenë kredituar shumat përkatëse tek KfW-ja sipas disponimit të lirë pa zbritje në euro dhe jo më vonë se ora 10 00, para dite, në Frankfurt mbi Main në llogarinë e KfW-së IBAN DE09 5002 0400 3102 5608 01 të mbajtur nga KfW-ja, Frankfurt am Main, me referencë shtesë të datës “Ref. VVVVMMDD”.

7.4 *Kundërpretendimet e Huamarrësit*. Huamarrësi nuk ka të drejtë të kërkojë ndonjë të drejtë për mbajtjen ose kompensimin e të drejtave të krahasueshme kundrejt detyrimeve të pagesës sipas kësaj marrëveshjeje huaje A, përveç kur këto të drejta njihen nga një vendim përfundimtar ose që nuk kundërshtohen nga KfW-ja.

7.5 *Kamatëvonesa*. Nëse shlyerjet e kësteve përkatëse ose shlyerjet e parakohshme në pajtim me nenin 6.4 (*shlyerja e parakohshme*) nuk vihen në dispozicion të KfW-së kur bëhen të kërkueshme, KfW-ja, pa njoftim paraprak, mund të vendosë kamatëvonesa me një normë prej 300 pikë bazë p.a. mbi normën bazë për periudhën që fillon në datën e kërkueshme dhe që përfundon në datën në të cilën këto pagesa kreditohen tek llogaria e KfW-së e specifikuar në nenin 7.3. Kjo normë duhet të jetë të paktën e barabartë me normën e interesit të huas A. “Norma bazë” është norma e interesit e njoftuar nga Banka Qendrore Gjermane (Deutsche Bundesbank) si normë bazë që mbizotëron në datën përkatëse të kërkueshme. Kjo kamatëvonesë bëhet menjëherë e kërkueshme me kërkesën e parë të KfW-së dhe duhet të paguhet brenda 10 ditëve bankare.

7.6 *Kompensimi me shumë të plotë*. Për shumat e prapambetura (më përjashtim të shlyerjeve të atyre kësteve dhe shlyerjeve të parakohshme që përmenden në nenin 7.5 (kamatëvonesa), KfW-ja, pa njoftim paraprak, mund të kërkojë një kompensim me shumë të plotë me një normë prej 300 pikë bazë p.a. mbi normën bazë të zbatueshme në datën përkatëse të kërkueshme për periudhën që fillon në datën e kërkueshme dhe që përfundon në datën e pagesës së këtyre shumave të prapambetura. Kompensimi me shumë të plotë bëhet menjëherë i kërkueshëm pas kërkesës së parë të KfW-së dhe duhet të paguhet brenda 10 ditëve bankare. Huamarrësi është i lirë të provojë që realisht nuk është shkaktuar dëm dhe që dëmet nuk janë shkaktuar në shumën e përcaktuar.

7.7 *Kompensimi*. KfW-ja ka të drejtën e kompensimit të pagesave të marra kundrejt pagesave të kërkueshme sipas kësaj marrëveshjeje huaje A ose sipas marrëveshjeve të tjera të huas të lidhura ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit. Në këtë rast, Huamarrësi informohet menjëherë nga KfW-ja. Kompensimi nuk shkakton një detyrim të përgjithshëm më të lartë pagese për Huamarrësin.

7.8 *Llogaritjet e bëra nga KfW-ja*. Në mungesë të gabimeve të dukshme, përcaktimet e KfW-së dhe llogaritjet e saj për shumat sipas kësaj marrëveshjeje huaje A dhe në lidhje me këtë marrëveshje huaje a përbën provë me shikim të parë.

## 8. Garancia nga Republika Federale Gjermane

KfW-ja merr garanci për pretendimet e pagesës sipas kësaj marrëveshjeje huaje A nga Republika Federale Gjermane para fillimit të disbursimit të parë.

### 9. Pengu negativ dhe *pari passu*

9.1 *Ndalimi i pengut dhe hipotekës*. Huamarrësi merr masa që sendet pasurore të programit të mos rëndohen me peng, hipotekë apo të tjetërsohen para shlyerjes së plotë të huas A dhe të mos lidhet asnjë marrëveshje apo masë tjetër, efekti i së cilës është krijimi i garancisë ose një të drejte me prioritet pagese në lidhje me një detyrim të një personi pa pëlqimin paraprak të KfW-së.

9.2 *Pari passu*. Në masën e lejuar nga ligji, Huamarrësi merr përsipër të përmbushë detyrimet sipas kësaj marrëveshjeje huaje A *pari passu* me të gjitha detyrimet e tjera ekzistuese ose të ardhshme të pasiguruarra ose të pavarura pagese.

#### 10. Kostoja dhe detyrimet publike

10.1 *Ndalimi i zbritjeve dhe ndalesave*. Huamarrësi i bën të gjitha pagesat sipas kësaj marrëveshjeje huaje A pa asnjë zbritje të tatimeve ose detyrimeve të tjera publike apo kostove të tjera. Në rastin kur Huamarrësi është i detyruar me ligj ose për shkaqe të tjera të kryejë këto zbritje apo ndalesa për pagesat, Huamarrësi paguan çdo shumë shtesë të nevojshme për KfW-në në mënyrë që shuma neto e mbetur pas ndalimit ose zbritjes të përputhet me shumën e cila do të ishte e pagueshme sipas kësaj marrëveshjeje huaje A, nëse këto zbritje ose ndalesa nuk do të ishin bërë.

10.2 *Kostoja*. Huamarrësi mbulon të gjithë koston dhe shpenzimet që mbliidhen në lidhje me disbursimin e huas A, veçanërisht koston e transfertave dhe dërgesave (duke përfshirë tarifën e konvertimit), si dhe të gjithë koston dhe shpenzimet e bëra në lidhje me mbajtjen dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje huaje A.

10.3 *Taksat dhe detyrimet e tjera*. Huamarrësi mbulon të gjitha tatimet dhe detyrimet e tjera publike që paguhet jashtë Republikës Federale Gjermane në lidhje me lidhjen dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje huaje A.

#### 10.4 *Kostoja e shtuar*. Nëse për shkak të:

a) përmbushjes së kërkesave të nxjerra nga një bankë qendrore ose autoritet tjetër fiskal, monetar apo tjetër autoritet pas datës së kësaj marrëveshjeje huaje A;

ose

b) çdo ndryshim në ligj ose interpretimin apo administrimin e tij;

ose

c) hyrjes në fuqi, prishjes ose ndryshimin e një traktati apo marrëveshjeje të zbatueshme biletarale ose multilaterale, veçanërisht për tatimin e dyfishtë,

KfW-ja bën shpenzime apo pëson humbje apo nuk është në gjendje të marrë marzhin e koston së rifinancimit si rezultat i lidhjes dhe financimit të kësaj marrëveshjeje huaje A (kosto të shtuara), KfW-ja njofton për këtë Huamarrësin. Çdo kërkesë e tillë nga KfW-ja shoqërohet nga një njoftim i KfW-së që përcakton bazën për këtë kërkesë dhe parashtron me hollësi të arsyeshme dhe të përshtatshme llogaritjen e kësaj shume. Huamarrësi zhdëmton menjëherë me kërkesë KfW-në për çdo kosto të tillë të shtuar. Neni 7 zbatohet *mutatis mutandis*.

#### 11. Detyrimet e veçanta

11.1 *Zbatimi i programit dhe informacioni specifik*. Huamarrësi, i përfaqësuar nga njësia e zbatimit të programit, merr masa vetë dhe merr gjithashtu masa që çdo agjenci e zbatimit të projektit:

a) të përgatitë, zbatojë, operojë dhe ruajë nënprojektet në pajtim me praktikën e qëndrueshme financiare dhe teknike, thelbësisht në pajtim me konceptin e programit të rënë dakord ndërmjet njësisë së zbatimit të programit, agjencive të zbatimit të projektit dhe KfW-së;

b) u cakton përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit për nënprojektet inxhinierëve konsulentë ose konsulentëve të pavarur dhe të kualifikuar dhe zbatimin nënprojekteve firmave të kualifikuara;

c) jep kontratat për mallrat dhe shërbimet që financohen nga huaja A me tender konkurrues ndërkombëtar paraprak;

d) siguron financim të plotë të programit dhe i jep KfW-së me kërkesë prova që provojnë se kostoja e papaguar nga kjo hua është e mbuluar;

e) mban libra dhe regjistra që tregojnë qartësisht koston e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për programin dhe që identifikojnë qartësisht mallrat dhe shërbimet e financuara nga kjo hua;





f) ndjek hapat e zbatimit të programit për përmirësimet e performancës të monitoruara rreptësisht, sipas përcaktimit në marrëveshjen e veçantë (marrëveshjet e veçanta për zbatimin). Çdo informacion i tillë duhet t'i jepet nga agjencitë e zbatimit të projektit huamarrësit dhe KfW-së;

g) merr masa që përfaqësuesit e KfW-së të jenë gjithmonë në gjendje të inspektojnë librat dhe regjistrat dhe të gjithë dokumentacionin përkatës për zbatimin dhe operimin e programit dhe për të vizituar programin dhe instalimet në lidhje me të;

h) i jep KfW-së dhe merr masa që çdo informacion i tillë dhe të dhënat e programit dhe progresit të tij të mëtejshëm t'i jepet KfW-së sipas kërkesës së KfW-së;

i) menjëherë dhe me pëlqimin e tij,

aa) i kalon KfW-së çdo pyetje të marrë nga agjencitë e zbatimit të projektit nga OECD-ja ose anëtarët e saj sipas të ashtuquajturës "Marrëveshja për transparencë të kredive të palidhura ODA", pas dhënies së kontratave për furnizimet dhe shërbimet që duhet të financohen nga huaja A dhe do të bashkërendojë kërkesën për çdo pyetje të tillë me KfW-në, dhe

bb) njofton KfW-në për çdo rrethanë që përjashton ose rrezikon seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e programit.

11.2 *Marrëveshje e veçantë*. Huamarrësi, i përfaqësuar nga njësi e zbatimit të programit, agjencitë e zbatimit të projektit dhe KfW-ja përcaktojnë hollësitë e nenit 11.1 me një marrëveshje të veçantë (siç parashikohet në nenin 1.2) që duhet të miratohet nga Ministria e Financave.

11.3 *Përputhshmëria*. Huamarrësi siguron vetë dhe merr masa që çdo agjenci e zbatimit të projektit të garantojë që të gjithë personat të cilëve u besojnë përgatitjen dhe zbatimin e programit, dhënien e kontratave për furnizimet dhe shërbimet që duhet të financohen, dhe kërkimin e shumave të huas të mos kërkojnë, pranojnë, bëjnë, japin apo premtojë ndonjë premtim për pagesa të paligjshme ose avantazhe të tjera në lidhje me këto detyra.

11.4 *Transporti i mallrave*. Dispozitat e parashikuara në marrëveshjen qeveritare zbatohen për transportin e mallrave që duhet të financohen nga huaja A.

## 12. Zgjidhja e kontratës

12.1 *Ngjarjet e qenies në vonesë*. KfW-ja mund të ushtrojë të drejtat e parashikuara sipas nenit 12.2 (pasojat ligjore të një ngjarjeje të qenies në vonesë), nëse ndodh një ngjarje që përbën shkak thelbësor (Wichtiger Grund). Veçanërisht, ngjarjet e mëposhtme përbëjnë shkak material:

a) Huamarrësi nuk përmbush detyrimet ndaj KfW-së për të bërë pagesat kur bëhen të kërkueshme;

b) detyrimet sipas marrëveshjes së huas A, marrëveshjes së huas B, marrëveshjes financiare ose sipas marrëveshjeve të veçanta në lidhje me këtë marrëveshje të huas A janë shkelur;

c) kjo marrëveshje huaje A ose një pjesë e saj pushon së paturi efekt detyrues për Huamarrësin ose pushon së qeni e ekzekutueshme ndaj Huamarrësit;

d) çdo deklaratë, konfirmim, informacion ose përfaqësim apo garanci e shqyrtuar nga KfW-ja si thelbësore për dhënien dhe ruajtjen e huas A del e rremë, e gabuar ose e paplotë;

e) ndodhin rrethana të tjera të jashtëzakonshme që vonojnë ose përjashtojnë përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj marrëveshjeje huaje A, ose

f) Huamarrësi ose një agjenci e zbatimit të projektit nuk është në gjendje të vërtetojë që shumat e huas janë përdorur për qëllimin e parashikuar;

g) një prej ngjarjeve të mëposhtme ndodh në lidhje me Huamarrësin:

aa) Huamarrësi nuk është në gjendje të paguajë borxhet kur bëhen të kërkueshme;

bb) fillimi i bisedimeve me një ose më shumë kreditorë të Huamarrësit (me përjashtim të KfW-së) për heqjen dorë nga borxhet e mbetura ose për një moratorium apo zgjidhje.

12.2 *Pasojat ligjore të ngjarjes së qenies në vonesë*. Nëse një prej ngjarjeve të përmendura në nenin 12.1 ka ndodhur dhe nuk është eliminuar brenda një periudhe prej pesë ditësh bankare (në rastin e nenit 12.1 a) ose, në të gjitha rastet e tjera të specifikuar në nenin 12.1, nuk është zgjidhur

brenda një afati të përcaktuar nga KfW-ja që, megjithatë, nuk mund të jetë më pak se 30 ditë, KfW-ja mund të zgjidhë këtë marrëveshje huaje A ose pjesë të saj me pasojën që:

a) detyrimet e saj sipas kësaj marrëveshjeje huaje A përfundojnë, dhe

b) KfW-ja mund të kërkojë shlyerje të plotë ose të pjesshme të shumës së mbetur të Huas së bashku me interesin e mbledhur dhe të gjitha shumat e tjera sipas kësaj marrëveshjeje huaje A. neni 7.5 (kamatëvonesa) dhe 7.6 (*Kompensimi me shumë të plotë*) zbatohen për shumat e përshpejtuara *mutatis mutandis*.

12.3 *Kompensimi për dëmet*. Në rast se kjo marrëveshje huaje A zgjidhet plotësisht ose pjesërisht para se të jetë bërë shlyerja e plotë, Huamarrësi paguan kompensimin për mospranimin sipas nenit 3.6 (*kompensimi i mospranimit*) dhe/ose kompensimin e pagimit të parakohshëm në pajtim me nenin 6.4 c (*kompensimi i pagesës së parakohshme*).

13. Përfaqësimet dhe deklaramet

13.1 *Përfaqësimet e Huamarrësit*. Ministri i Financave dhe ata persona që caktohen prej tij ose saj për KfW-në dhe autorizohen nëpërmjet ekzemplarëve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij ose saj e përfaqësojnë huamarrësin në zbatimin e kësaj marrëveshjeje huaje A. Drejtori i Përgjithshëm (ose në rastin e Kamzës, përkatësisht kryetari i bashkisë) e çdo agjencie të zbatimit të projektit dhe ata persona që caktohen prej tij ose saj për KfW-në dhe autorizohen nëpërmjet ekzemplarëve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij ose saj e përfaqësojnë huamarrësin në zbatimin e kësaj marrëveshjeje huaje A. Fuqia e përfaqësimit nuk skadon derisa anulimi shprehimisht nga përfaqësuesi i Huamarrësit të autorizuar për atë kohë të jetë marrë prej KfW-së.

13.2 *Adresat*. Njoftimet dhe deklaramet në lidhje me këtë marrëveshje huaje A duhet të jenë me shkrim. Ato duhet të dërgohen në origjinal ose – me përjashtim të kërkesave për disbursim – nëpërmjet faksit. Secili dhe të gjithë njoftimet ose deklaramet e bëra në lidhje me këtë marrëveshje huaje A duhet të dërgohen në adresat e mëposhtme:

Për KfW-në: KfW  
Departament: LEa4 – Municipal Infrastructure  
South East Europe and Turkey  
Postfach 11 11 41  
60046 Frankfurt am Main  
Federal Republic of Germany  
Faks +49 69 7431 2944

Për Huamarrësin: Ministria e Financave  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr.1  
Tirana  
Shqipëri  
Faks (+355) 4 222 8494

14. Dispozita të përgjithshme

14.1 *Ditë bankare*. Nëse në këtë marrëveshje huaje A bëhet referencë tek një “Ditë bankare”, kjo do të thotë një ditë e ndryshme nga një e shtunë ose e diel, në të cilën bankat tregtare në Frankfurt mbi Main janë të hapura për biznes të përgjithshëm.

14.2 *Vendi i përmbushjes*. Vendi i përmbushjes së të gjitha detyrimeve sipas kësaj marrëveshjeje huaje A është Frankfurt am Main, Republika Federale Gjermane.

14.3 *Pavlefshmëria e pjesshme dhe boshllëqet*. Nëse një dispozitë e kësaj marrëveshjeje huaje A është ose bëhet e pavlefshme, ose nëse ka një boshllëk në një prej dispozitave të kësaj marrëveshjeje huaje, kjo nuk ndikon në vlefshmërinë e dispozitave të tjera. Palët e kësaj marrëveshjeje huaje A e zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një dispozitë ligjërish të vlefshme që vjen sa më afër që të jetë e mundur frymës dhe qëllimit të dispozitës së pavlefshme.



Palët e mbushin çdo boshllëk në dispozita me një dispozitë ligjërish të vlefshme që vjen sa më afër frymës dhe qëllimit të kësaj marrëveshjeje huaje A.

14.4 *Forma e shkruar dhe ndryshimi.* Ndryshimet dhe shtesat në këtë kontratë duhet të bëhen me shkrim. Çdo heqje dorë nga kjo kërkesë e formës me shkrim duhet të deklarohet nga palët me shkrim.

14.5 *Kalimi i të drejtave.* Huamarrësi nuk mund të kalojë, transferojë, rëndojë me peng apo hipotekë asnjë pretendim nga kjo marrëveshje huaje A.

14.6 *Ligji i zbatueshëm.* Kjo marrëveshje huaje A rregullohet nga ligjet e Republikës Federale Gjermane.

14.7 *Afati i parashkrimit.* Të gjitha pretendimet e KfW-së sipas kësaj marrëveshje huaje A mbarojnë pesë vjet nga fundi i vitit në të cilin kanë lindur këto të drejta dhe në të cilin KfW-ja ka ardhur në dijeni të rrethanave që përbëjnë këtë pretendim ose mund të kishte ardhur në dijeni pa neglizhencë të dukshme.

#### 14.8 *Heqja dorë nga imuniteti*

a) Në masën që Huamarrësi, tashmë ose në të ardhmen, në një juridiksion mund të pretendojë për vete ose sendet pasurore të tij imunitet nga padia, ekzekutimi, sekuestrimi ose një proces tjetër ligjor dhe në masën që në këtë juridiksion mund të merret për vetë ose sendet pasurore një imunitet i tillë, Huamarrësi, në mënyrë të pakthyeshme, bie dakord të mos ngrejë pretendim dhe në mënyrë të pakthyeshme heq dorë nga ky imunitet në masën më të gjerë të lejuar nga ligji i këtij juridiksioni.

b) Në asnjë rast Huamarrësi nuk heq dorë nga imuniteti, në lidhje me ekzekutimin, në lidhje me:

i) “mjediset e misionit” të tashme ose të ardhshme sipas përcaktimit në Konventën e Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike të nënshkruar në 1961, “mjediset konsullore” të tashme ose të ardhshme sipas përcaktimit në Konventën e Vjenës mbi marrëdhëniet konsullore të nënshkruar në 1963 ose ndryshe të përdorura nga një diplomat ose mision diplomatik në Shqipëri ose një agjenci ose instrument i saj;

ii) çdo pasuri e paluajtshme që përfshihet në dispozitat e nenit 3, paragrafi 1-3 i ligjit shqiptar nr 8743, datë 22.2.2001 “Mbi pasuritë e paluajtshme shtetërore”;

iii) çdo fond monetar dhe/ose shumë që është bërë e kërkueshme dhe paguar në momentin e ekzekutimit për përmbushjen e detyrimeve që ka Republika e Shqipërisë sipas traktateve ndërkombëtare të së drejtës publike, konventave dhe/ose marrëveshjeve të nënshkruara prej saj.

#### 14.9 *Mosmarrëveshjet ligjore*

*Arbitrazhi.* Të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin nga ose në lidhje me këtë marrëveshje huaje A zgjidhen ekskluzivisht dhe përfundimisht nga një gjykatë arbitrazhi. Në këtë aspekt, zbatohen sa më poshtë:

a) Gjykata e arbitrazhit përbëhet nga një ose tre arbitra që emërohen dhe veprojnë në pajtim me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) që ndryshohet herë pas here.

b) Gjykimet në arbitrazh kryhen në Frankfurt am Main. Gjykimet zhvillohen në gjuhën angleze.

14.10 *Transmetimi i informacionit.* KfW-ja ka të drejtë t’i transmetojë lëshuesit të garancisë federale të përmendur në nenin 8 dhe Republikës Federale Gjermane informacion në lidhje me përfundimin dhe nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje huaje A. KfW-ja dhe Republika Federale Gjermane kanë të drejtë të kalojnë informacionin në lidhje me huan A dhe programin, duke përfshirë dhënien e kontratave për furnizime dhe shërbime që financohen nga huaja A tek organizatat ndërkombëtare të angazhuara në mbledhjen e të dhënave statistikore, veçanërisht në lidhje me çështjet në lidhje me shërbimin e borxhit dhe/ose mbledhjen dhe publikimin e të dhënave

në lidhje me dhënien e kontratave për furnizimet dhe shërbimet që financohen nga huaja A. E drejta e mësipërme për të dhënë informacion tek organizatat ndërkombëtare përfshin edhe të drejtën për të kaluar drejtpërdrejt këtë informacion tek anëtarët e këtyre organizatave.

14.11. *Hyrja në fuqi.* Kjo marrëveshje huaje A hyn në fuqi jo më parë se Huamarrësi të ketë informuar KfW-në me shkrim që marrëveshja e huas A është ratifikuar dhe ratifikimi është publikuar sipas rregullave.

Kjo marrëveshje huaje A nënshkruhet në 2 kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt mbi Main (të plotësohet)

KfW

Nga: _____	Nga: _____
Emri: _____	Emri: _____
Titulli: _____	Titulli: _____

Tiranë, (të plotësohet)

Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave

Nga: _____	
Emri: _____	Ridvan Bode
Titulli: _____	Ministër i Financave

Aneksi 1

#### GRAFIKU I DISBURSIMIT

Në fund të çdo periudhe të treguar më poshtë, Huamarrësi do të ketë kërkuar disbursimin e shumave të huas që nuk kalojnë në total shumën e treguar më poshtë për çdo periudhë (të gjitha shifrat në euro).

	Disbursuar në këtë periudhë	Disbursuar në periudhën e mëparshme	Disbursimi total
2/2011			
1/2012			
2/2012	800 000		800 000
1/2013	1 600 000	800 000	2 400 000
2/2013	3 200 000	2 400 000	5 600 000
1/2014	1 500 000	5 600 000	7 100 000
2/2014	2 600 000	7 100 000	9 700 000
1/2015	1 400 000	9 700 000	11 100 000
2/2015	1 000 000	11 000 000	<b>12 000 000</b>



Shënim. Jeni të lutur të ndryshoni “Republika e VENDI” / “VENDI” përkatësisht.  
Jeni të lutur të ndryshoni “Marrëveshja e huas” me “Marrëveshja e huas A dhe marrëveshja e huas B”

Formati i opinionit ligjor të Këshilltarit Ligjor të Huamarrësit (Shteti)

*(Koka e letrës së këshilltarit ligjor)*

(datë)

KfW-ja

Departamenti [ ]

Në vëmendje të: [.....]

Palmengartenstrasse 5-9

Postfach 11 11 41

60325 Frankfurt am Main / Germany

Republika Federale Gjermane

Marrëveshje huaje e datës ..... e lidhur ndërmjet KfW-së [...] (Huamarrësi) dhe [...] për një shumë që nuk kalon në tërësi \_\_000.000,- euro.

Të nderuar zotërinj,

Unë jam (Ministri i Drejtësisë së) (këshilltari ligjor) (shefi i departamentit juridik të ..... (jeni të lutur të specifikoni ministrinë ose autoritetin tjetër) të) Republika e VENDIT. Unë kam vepruar në këtë cilësi në lidhje me marrëveshjen e huas (marrëveshja e huas), të datës ....., të lidhur ndërmjet Huamarrësit, (...) dhe jush mbi një hua që duhet të jepet prej jush tek Huamarrësi në një shumë që nuk kalon në tërësi \_\_000.000,- euro.

1. Dokumentet e shqyrtuara

Unë kam shqyrtuar:

1.1 një kopje origjinale autentike të nënshkruar të marrëveshjes së huas;

1.2 dokumentet kushtetuese të Huamarrësit, veçanërisht:

(a) Kushtetutën e Republikës së VENDI, datë ....., të publikuar rregullisht në ....., nr ....., faqe ....., e ndryshuar;

b) Ligjin(et) nr ....., datë ....., të publikuar rregullisht në ....., nr ....., faqe....., të ndryshuar (jeni të lutur të përfshini, sipas rastit, ligjet (p.sh., ligjet e buxhetit) në lidhje me huamarrjen nga Republika e VENDIT);

c) ..... (jeni të lutur t’u referoheni dokumenteve të tjerë, p.sh., dekreteve ose rezolutave të organeve qeveritare ose administrative të VENDIT mbi lidhjen e marrëveshjeve të huas nga VENDI në përgjithësi ose mbi përfundimin e marrëveshjes së huas); dhe

d) Marrëveshjen e bashkëpunimi financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së VENDIT dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, datë ..... (marrëveshje bashkëpunimi)

dhe ligje, rregullore, certifikata, regjistra, regjistrime dhe dokumente të tjera dhe kam bërë ato hetime që i kam konsideruar të nevojshme ose të dëshirueshme për qëllimin e dhënies së këtij opinionit.

2. Opinioni

Për qëllimin e nenit ..... të marrëveshjes së huas, unë jam i mendimit se sipas ligjeve të Republikës së VENDIT të kësaj date:

2.1 Në pajtim me nenin ..... të Kushtetutës / neni .... të ligjit mbi (jeni të lutur të specifikoni sipas rastit), Huamarrësi ka të drejtë të lidhë marrëveshjen e huas dhe ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të autorizuar nënshkrimin, dorëzimin dhe përmbushjen e marrëveshjes së huas, veçanërisht nëpërmjet:

a) Ligjet (eve) nr ....., datë ....., të parlamentit të Republikës së VENDIT, që ratifikon marrëveshjen e huas / aprovon nënshkrimin, dorëzimin dhe përmbushjen e marrëveshjes së huas nga Huamarrësi / ..... (jeni i lutur të plotësoni sipas rastit);

b) Vendimin(et) nr ..... datë ..... të kabinetit të Këshillit të Ministrave / të komitetit të huave shtetërore / ..... (jeni të lutur të plotësoni organet qeveritare ose administrative të VENDIT sipas rastit);

c) ..... (jeni të lutur t'u referoheni rezolutave, vendimeve etj).

2.2 Znj/z ..... (dhe znj/z ..... ) është (janë) të autorizuar rregullisht nga ..... (p.sh., ligjërish në saj të pozicionit të tij/saj si (Ministër i .... / si....), me vendim qeverie ....., me prokurë të ....., datë ....., etj.) për të nënshkruar vetëm/bashkërisht marrëveshjen e huas në emër të Huamarrësit. Marrëveshja e huas e nënshkruar nga znj/z ..... (dhe znj/z ..... ) është nënshkruar rregullisht në emër të Huamarrësit dhe përbën një detyrim ligjërish detyruës të Huamarrësit të ekzekutueshëm ndaj tij ligjërish, në pajtim me kushtet e tij.

(Alternativa 1 për seksionin 2.3, që duhet të përdoret nëse janë bashkë me dokumentet e specifikuar në seksionin 2.1 dhe 2.2, autorizime të caktuara zyrtare etj., që duhet të merren sipas ligjeve të Republikës së VENDIT:)

2.3 Për nënshkrimin dhe përmbushjen e marrëveshjes së huas nga Huamarrësi (duke përfshirë pa kufizim përfitim dhe transferimin tek KfW-ja të të gjitha shumave të kërkueshme në monedhat e specifikuar), aprovimet, autorizimet, licencat, regjistrimet dhe/ose pëlqimet e nevojshme zyrtare janë marrë dhe janë plotësisht në fuqi:

a) Aprovimi i ..... (Bankës Qendrore/Bankës Kombëtare/.....) datë ....., nr .....

b) Pëlqimi i ..... (Ministri/Ministria e .....), datë ....., Nr .....

c) ..... (jeni të lutur të rendisni çdo autorizim, licencë dhe/ose aprovim zyrtar).

Asnjë autorizim, pëlqim, licencë, regjistrim dhe/ose aprovim zyrtar tjetër i një autoriteti ose agjencie qeveritare (duke përfshirë Bankën Qendrore/kombëtare të Republikës së VENDIT) ose gjykatë nuk kërkohet dhe nuk është e këshillueshme në lidhje me nënshkrimin dhe përmbushjen e marrëveshjes së huas nga huamarrësi (duke përfshirë pa kufizim marrjen dhe transferimin tek KfW-ja të të gjitha shumave në monedhat e specifikuar) dhe vlefshmërinë dhe ekzekutueshmërinë e detyrimeve të Huamarrësit sipas marrëveshjes së huas.

(Alternativa 2 për seksionin 2.3, që përdoret vetëm si shtesë e dokumenteve të specifikuar në seksionin 2.1 dhe 2.2, asnjë autorizim zyrtar nuk duhet të merret sipas ligjeve të Republikës së VENDIT:)

2.3 Asnjë autorizim, pëlqim, licencë, regjistrim dhe/ose aprovim zyrtar tjetër i një autoriteti ose agjencie qeveritare (duke përfshirë Bankën Qendrore/kombëtare të Republikës së VENDIT) ose gjykatë nuk kërkohet dhe nuk është e këshillueshme në lidhje me nënshkrimin dhe përmbushjen e marrëveshjes së huas nga Huamarrësi (duke përfshirë pa kufizim marrjen dhe transferimin tek KfW-ja të të gjitha shumave në monedhat e specifikuar) dhe vlefshmërinë dhe ekzekutueshmërinë e detyrimeve të Huamarrësit sipas marrëveshjes së huas.



2.4 Asnjë taksë pulle apo taksë apo detyrim i ngjashëm nuk duhet të paguhet në lidhje me vlefshmërinë ose ekzekutueshmërinë e marrëveshjes së huas.

2.5 Zgjedhja e ligjit gjerman për të rregulluar marrëveshjen e huas dhe paraqitja për arbitrazh në pajtim me nenin 14.9 të marrëveshjes së huas janë të vlefshme dhe detyruese. Vendimet e arbitrazhit ndaj Huamarrësit janë të njohura dhe të ekzekutueshme në Republikën e VENDIT në pajtim me rregullat e mëposhtme: ... (jeni të lutur të plotësoni traktatin e zbatueshëm (sipas rastit), p.sh., Konventa e Nju-Jorkut e vitit 1958, dhe/ose parimet bazë në lidhje me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit në VEND).

2.6 Gjykatat e Republikës së VENDIT kanë të drejtën të japin vendime të përcaktuara në monedhën ose monedhat e specifikuar në marrëveshjen e huas.

2.7 Huamarrja nga Huamarrësi sipas marrëveshjes së huas dhe nënshkrimi dhe përmbushja nga Huamarrësi i marrëveshjes së huas përbëjnë veprime juridike private dhe tregtare dhe jo veprime juridike qeveritare ose publike. As Huamarrësi, dhe as pasuria e tij nuk ka të drejtën e imunitetit nga arbitrazhi, padia, ekzekutimi, sekuestrimi ose procese të tjera ligjore. Megjithatë, Huamarrësi nuk ka hequr dorë nga imuniteti në lidhje me ekzekutimin në lidhje me:

- "mjediset e misionit" të tashme ose të ardhshme sipas përcaktimit në Konventën e Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike të nënshkruar në 1961, ose "mjediset konsullore" të tashme ose të ardhshme sipas përcaktimit në Konventën e Vjenës mbi marrëdhëniet konsullore të nënshkruar në 1963 ose ndryshe të përdorura nga një diplomat ose mision diplomatik në Shqipëri ose një agjenci ose instrument i saj;

- çdo pasuri e paluajtshme që përfshihet në dispozitat e nenit 3, paragrafi 1-3 i ligjit shqiptar nr. 8743, datë 22.2.2001 "Mbi pasuritë e paluajtshme shtetërore";

- çdo fond monetar dhe/ose shumë që është bërë e kërkueshme dhe paguar në momentin e ekzekutimit për përmbushjen e detyrimeve që ka Republika e Shqipërisë sipas traktateve ndërkombëtare të së drejtës publike, konventave dhe/ose marrëveshjeve të nënshkruara prej saj.

2.8 Marrëveshja e bashkëpunimit është në fuqi të plotë sipas kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së VENDIT. (Në pajtim me nenin 3 të marrëveshjes së bashkëpunimit) (Nëse Marrëveshja e Bashkëpunimit nuk ka hyrë në fuqi, por nuk ekziston një marrëveshje e tatimit të dyfishtë). Në pajtim me ..... (jeni të lutur të specifikoni traktatin ose ligjet dhe rregulloret e zbatueshme) / Huamarrësit nuk i kërkohet të bëjë ndonjë zbritje ose ndalim nga ndonjë pagesë që Huamarrësi duhet të bëjë sipas marrëveshjes së huas dhe nëse kjo zbritje ose ndalesë duhet të vendoset më vonë, dispozitat e nenit 10.1 të marrëveshjes së huas zbatohen për t'i kërkuar Huamarrësit të zhdëmtojë KfW-në sipas rregullave.

2.9 KfW-ja nuk është dhe nuk konsiderohet të jetë rezidente, me banim, të zhvillojë biznes ose t'i nënshtrohet tatimit në republikën e VENDIT për shkak vetëm të nënshkrimit, përmbushjes ose ekzekutimit të marrëveshjes së huas. Nuk është e nevojshme ose e këshillueshme që KfW-ja të jetë e licencuar, kualifikuar ose me të drejta të tjera të zhvillojë biznes ose që KfW-ja të emërojë agjentë ose përfaqësues në Republikën e VENDIT.

Për pasojë, detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas përbëjnë detyrime ligjore, të vlefshme dhe detyruese të drejtpërdrejta dhe pa kushte të Huamarrësit, të cilat janë të ekzekutueshme ndaj Huamarrësit në pajtim me kushtet e tyre përkatëse.

Ky opinion ligjor është i kufizuar për ligjet e Republikës së VENDIT.

.....

(vendi)

(datë)

(nënshkrimi)

Emri:

**Bashkëlidhur:**

Shënim. Jeni të lutur të bashkëlidhni fotokopje të vërtetuara të dokumenteve dhe dispozitave ligjore të përmendura më sipër sipas seksionit 1.2 (a) deri 1.2 (c) dhe seksionit 2.1 deri 2.3 dhe 2.8 (në lidhje me ligjet me tekst të gjatë ose Kushtetutën e Republikës së VENDIT, një kopje e dispozitave përkatëse do të ishte e mjaftueshme) dhe t'i jepni KfW-së një përkthim të vërtetuar në anglisht ose gjermanisht të secilës prej dokumenteve të mësipërme, nëse ky dokument nuk është lëshuar në anglisht ose gjermanisht si gjuhë zyrtare.

<p><b>Ministria e Punëve Publike dhe Transportit</b> Sheshi “Skënderbej”, nr. 5 Tiranë Shqipëri</p>	<p>Corinna Engel Referenca jonë: Eng Tel. +49 (0) 69 7431 2594 E-mail: <a href="mailto:corinna.engel@kfw.de">corinna.engel@kfw.de</a> Data: (të plotësohet)</p>
---	---

LE a4 Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë  
Programi “Infrastruktura bashkiake II”,  
12 milionë euro (Huaja A)  
BMZ-Nr. 2010 65 705  
2 milionë euro (Huaja B)  
BMZ-Nr. 2010 66 315  
20, 482, 000 euro (Kontributi financiar)  
BMZ-Nr 2020 60 408 dhe BMZ-Nr. 2020 60 242  
Marrëveshje e veçantë për marrëveshjen e huas A të datës 20 mars 2012,  
për marrëveshjen e huas B të datës 20 mars 2012  
dhe për marrëveshjen e financimit mbi kontributin financiar të dhënë nga Bashkimi European të datës 20 mars 2012

Të nderuar zotërinj,

Ne i referohemi programit të infrastrukturës bashkiake II të KfW-së për furnizimin me ujë dhe kanalizimet për qytetet e Beratit, Fierit, Kamzës, Kuçovës, Lushnjës dhe Sarandës (Programi) dhe marrëveshjes përkatëse të huas të datës (20 mars 2012) (marrëveshja e huas A) prej 12 milionë euro (huaja A), marrëveshjes së huas të datës (20 mars 2012) (marrëveshja e huas B) prej 2 milionë euro (huaja B) ndërmjet KfW-së dhe Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave (Huamarrësi) dhe marrëveshjes së financimit prej 20, 482, 000 euro të lidhur ndërmjet KfW-së dhe Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave (përfituesi) 20 marsit të 2012.

Marrëveshjet e sipërpërmendura janë të njohura për secilën prej UK Berat-Kuçovë, UK Fier, departamenti i ujit të bashkisë së Kamzës, UK Lushnja dhe UK Saranda që veprojnë si agjenci për zbatimin e projektit (së bashku “agjencitë e zbatimit të projektit”, secila “agjenci e zbatimit të projektit”, PEA) të programit dhe zbatimin e tij në çdo qytet përkatës (secili “nënprojekt”). Secila prej agjencive të zbatimit të projektit bie dakord për marrëveshjen e sipërpërmendur të huas A dhe B dhe marrëveshjen e financimit dhe në veçanti e njeh rolin e saj si agjenci e zbatimit të projektit në lidhje me nënprojektin dhe bie dakord të marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet përkatëse dhe të përmbushë rregullisht të gjitha detyrimet sipas marrëveshjes së huas A dhe B dhe marrëveshjes së financimit në lidhje me programin, siç specifikohet më tej në marrëveshjen e huas A





dhe B dhe marrëveshjen e financimit, siç specifikohet këtu më tej. Në pajtim me marrëveshjen e huas A dhe B dhe marrëveshjen e financimit, sa më poshtë përcaktohet me marrëveshje të veçantë:

Në pajtim me nenin 1.2 të marrëveshjes së huas A dhe B dhe marrëveshjen e financimit:

Hollësitë e programit si dhe mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga huaja;

Në pajtim me nenin 3.4 të marrëveshjes së huas A, nenin 3.1 të marrëveshjes së huas B dhe nenin 2.1 të marrëveshjes së financimit:

Procedurën e disbursimit, veçanërisht të dhënat që provojnë se shumatat e disbursuara të huas janë përdorur për qëllimet e përcaktuara;

Në pajtim me nenin 11.2 të marrëveshjes së huas A, nenin 8.2 të marrëveshjes së huas B dhe nenin 7.2 të marrëveshjes së financimit:

Hollësitë që u përkasin neneve të sipërpërmendur në lidhje me zbatimin e programit dhe informacionin e veçantë.

Ne propozojmë të bihet dakord sa më poshtë:

#### I. Projektimi i programit

##### 1. Hollësitë e programit

Programi ka të bëjë me përmirësimin e sistemit të furnizimit me ujë dhe kanalizime në bashki të zgjedhura të Shqipërisë, që janë bashkitë e Beratit, Fierit, Kamzës, Kuçovës, Lushnjës dhe Sarandës. Ky program i infrastrukturës bashkiake II pason programin e infrastrukturës bashkiake I të KfW-së. Qëllimi i programit është të sigurojë furnizim të qëndrueshëm dhe higjienikisht të sigurt për popullatën e qyteteve të programit me mbulim të shpenzimeve dhe tarifa shoqërisht të mbulueshme, si dhe të sigurojë higjienë të përshtatshme nëpërmjet shkarkimit të ujërave të zeza. Kjo do të kontribuojë për një përdorim të efektshëm të burimeve ujore dhe për mbrojtjen e mjedisit me përmirësim paralel të kushteve të jetesës, punës dhe shëndetit të popullsisë. Kriteret për arritjen e këtyre objektivave, rezultatet e programit dhe aktivitetet e kërkuara të programit si dhe supozimet në mbështetje të qëllimit të programit dhe rezultatet e programit gjenden në Aneksin 1.

Projektimi i programit bazohet në analizën institucionale të MACS GmbH të datës qershor 2010 dhe studime e parafizibilitetit nga Kocks Consult dhe White Young Green Consult të tetorit 2011 në dispozicion të KfW-së, Huamarrësit, Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, që vepron si njësi e zbatimit të programit ("Njësia e zbatimit të programit", PIU) dhe ndërmarrjeve të ujit dhe përkatësisht departamentit të ujit të Kamzës (agjencitë e zbatimit të programit) dhe në marrëveshjet ndërmjet KfW-së, Huamarrësit, njësisë së zbatimit të programit dhe agjencive të zbatimit të programit gjatë vlerësimit të programit lokal në nëntor/dhjetor 2010, të përcaktuar në procesverbalin e mbledhjes të datës 2 dhjetor 2010.

Aktivitetet e mëposhtme të programit financohen nga huaja A dhe B dhe/ose kontributi financiar:

- Berati dhe Kuçova:

- Prokurimi dhe instalimi i matësve të ujit;

- Zëvendësimi i pjesshëm i tubacionit të transmetimit nga Bugova në Berat dhe zëvendësimi i rrjetit të shpërndarjes në fshatra;

- Zëvendësimi i rrjetit të shpërndarjes në qendër të Beratit dhe në Kuçovë;

- Ndërtimi i tubacionit të transmetimit nga rezervuari i Koksit në rezervuarin e Drizës;

- Pajisjet operationale (kalibrimi i matësve të ujit, etj);

- Lidhjet e reja të fshatrave me rezervuarin e Drizës;

- Rrethimi i impiantit të trajtimit të ardhshëm të ujërave të zeza (WWTP);

- Ndërtesa e operationeve.

Fier:

- Lidhja e Levanit dhe Frakullit nëpërmjet tubacionit të veçantë të transmetimit, duke përfshirë kapacitetin shtesë të rezervuarit dhe pompat e reja të pusit;

- Rrethimi në të ardhmen i zonës WWTP;
- Rehabilitimi i rrjetit ekzistues të kanalizimeve në qendër të qytetit dhe/ose zgjerimi i rrjetit të kanalizimeve në zonat perëndimore, në varësi të rezultateve të inspektimit CCTV.

Kamza:

- Prokurimi dhe instalimi i matësve të ujit për ekonomitë shtëpiake;
  - Tubacioni i transmetimit (nga rezervuari i ujit WTP);
  - Impianti i trajtimit të ujit;
  - Rezervuari;
  - Rrjeti i shpërndarjes, instalimi i lidhjeve të reja;
  - Pajisja operationale për shkarkimin e ujit dhe kanalizimet (identifikimi i humbjeve etj).
- Lushnja:
- Zëvendësimi i rrjetit të shpërndarjes në zonën e qytetit;
  - Matësit shtesë të ujit;
  - Rrethimi i zonës së WWTP-së në të ardhmen;
  - Pajisjet operationale;
  - Ndërtesa e operationeve, duke përfshirë ruajtjen dhe punishtet.
- Saranda:
- Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjeteve të shpërndarjes së ujit në Sarandë;
  - Pajisjet operationale të matësve të ujit me shumicë, duke përfshirë ndërtesën operationale të jashtme.

## 2. Grafiku kohor

Grafiku përkatës kohor për përgatitjen, zbatimin dhe operimin e programit gjendet në aneksin 2.

## 3. Kostoja totale dhe financimi

Kostoja totale e llogaritur e programit (kostoja totale) që mbështet vlerësimin e programit është rreth 34.5 milionë euro. Shuma e huas është 12 milionë euro për huanë A dhe 2 milionë euro për huanë B për të financuar investimet në vendndodhjet e programit në Berat, Fier, Kamzë, Kuçovë, Lushnjë dhe Sarandë. Përveç kësaj, ka edhe një grant të BE-së (kontributi financiar) në shumën totale prej 20. 482. 000 euro. Parashikohet nën instrumentin e paraaderimit 2009 (IPA 2009) prej 5.39 milionë euro dhe sipas IPA 2010 prej 15.092 milion Euro që ndërmjet zërave të tjerë do të përfshijë veçanërisht shërbimet e konsulencës. Përbërja e koston totale dhe plani i financimit gjenden në aneksin 3.

## 4. Ndryshimet në projektimin e programit

Çdo ndryshim thelbësor në projektimin e programit kërkon pëlqimin paraprak të KfW-së dhe të Huamarrësit/përfituesit. Njësia e zbatimit të programit dhe/ose agjencitë e zbatimit të projektit njofton menjëherë për këtë KfW-në, duke përcaktuar shkaqet, masat e planifikuara dhe pasojat e ndryshimit (duke përfshirë koston totale). Ekzekutimi i këtyre masave mund të fillojë vetëm mbi bazën e planifikimit të rishikuar dhe me pëlqimin e KfW-së.

Studimi i fizibilitetit që duhet të përditësohet kërkon pëlqimin e ndërsjellë të KfW-së, PIU-t dhe bashkisë së Kamzës para disbursimit të parë për nënprojektin e Kamzës.

## II. Zbatimi i programit

### 1. Përgjegjësitë dhe grafiku i kohës, koston dhe financimit

1.1 Ministria e Punëve Publike dhe Transportit është përgjegjëse për zbatimin e programit. Brenda këtij institucioni do të emërohet personeli në Drejtorinë e Përgjithshme për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet (GDWSS) për të formuar njësinë e zbatimit të programit (PIU). Ndërmarrjet e ujit pjesërisht në pronësi të bashkimeve përkatëse janë përgjegjëse për zbatimin dhe operimin e nënprojekteve të veçantë nën mbikëqyrjen e PIU-t. Të gjitha palët bashkëpunojnë ngushtësisht gjatë përgatitjes dhe zbatimit të programit dhe përcaktojnë me marrëveshje të përbashkët aspektet e programit që janë thelbësore për operimin e tij.



1.2 Grafiku i detajuar i kohës, kostos dhe financimit, i përditësuar rregullisht për zbatimin e duhur teknik dhe financiar të programit, përgatitet sa më shpejt të jetë e mundur nga njësia e zbatimit të programit në bashkëpunim me konsulentin dhe i paraqitet KfW-së. Ky grafik duhet të tregojë, me afate dhe shuma, ndërlidhjen kronologjike të aktiviteteve të Programit dhe kërkesat financiare rezultuese. Nëse një shmangie nga ky grafik bëhet i nevojshëm gjatë zbatimit të programit, KfW-së i jepet një grafik i rishikuar.

## 2. Caktimi i një konsulenti

2.1 Bazuar në dokumentacionin e disponueshëm, ndërmarrjet e ujit të Berat-Kuçovës, Fierit, Lushnjës dhe Sarandës dhe departamenti i ujit në bashkinë e Kamzës me asistencën e konsulentit të zbatimit (Konsulenti i zbatimit) do të kryejnë një projektim të hollësishëm, përpilojnë dokumentet e tenderit dhe prokurojnë mallrat dhe shërbimet. Konsulenti i zbatimit asiston ndërmarrjet e ujit në mbikëqyrjen e punëve të ndërtimit dhe periudhën e përgjegjësisë për defektet. Konsulenti i zbatimit kontraktohet nga njësia e zbatimit të programit. Në rast se shuma e kontratës së konsulentit kalon në nivel të konsiderueshëm buxhetin sipas aneksit 3, Huamarrësi duhet të aprovojë buxhetin e rishikuar.

2.2 Për masat institucionale në Lushnjë, Kamzë dhe Sarandë angazhohet një konsulent institucional (konsulent institucional) për të mbështetur ndërmarrjet në uljen e humbjeve administrative dhe në rishikimin e tarifave dhe planeve të biznesit për të përmirësuar situatën e tyre të të ardhurave në mënyrë të konsiderueshme (për t'u financuar nga kontributi financiar). Ky konsulent institucional do të kontraktohet nga njësia e zbatimit të programit.

2.3 Pas parapërzgjedhjes dhe ofertimit konkurrues ndërkombëtare publik, detyrat (për konsulentin e zbatimit dhe konsulentin institucional) jepen në kontrata të veçanta për shoqëritë e pavarura të kualifikuara konsulente. Procedura për dhënien e kontratës rregullohet nga “Udhëzimet për caktimin e konsulentëve në bashkëpunimin financiar me vendet në zhvillim” (aneksi 4) që përbën pjesë integrale të kësaj. Dokumentet e tenderit do të përfshijnë një deklaratë që përshtatshmëria e ofertuesve, ndërmjet faktorëve të tjerë, do t'i nënshtrohet verifikimit nga Bashkimi Europian (BE) bazuar në sistemin e brendshëm të BE-së për paralajmërimin paraprak.

2.4 Në njoftimin e parakualifikimit ose-nëse nuk kryhet parakualifikim-në ftesën për tender, njësia e zbatimit të programit i detyron ofertuesit të paraqesin së bashku me dokumentet e tenderit ose së bashku me ofertën, një deklaratë angazhimi të nënshkruar sipas rregullave (aneksi 4, faqe 16).

2.5 Njësia e zbatimit të programit i kërkon KfW-së të autorizojë një ekspert (agjent tenderi) të asistojë njësinë e zbatimit të programit në zgjedhjen dhe kontraktimin e konsulentit të zbatimit dhe konsulentin institucional. Specifikisht, agjenti i tenderit asiston njësinë e zbatimit të programit me shërbimet e mëposhtme:

- Hartimin e termave të referencës për shërbimet e konsulencës, duke përfshirë një projektkontratë konsulence (kontratë standarde konsulence e KfW-së);
- Përmblidhjen e parakualifikimit dhe “renditjen paraprake” për ofertuesit e kualifikuar;
- Kryerjen e tenderit, duke përfshirë propozimin e arsyetuar për dhënien e kontratës;
- Paraqitjen e një projektkontrate konsulence që është negociuar me konsulentët.

Kostoja e shkaktuar për agjentin e tenderit mbulohet nga një grand i veçantë që jepet për këtë qëllim nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).

2.6 Brenda dy javëve pasi njësia e zbatimit të programit dhe KfW-ja të kenë marrë propozimet e agjentit të tenderit në lidhje me termat e referencës, propozimet dhe dhënien e kontratave dhe projektkontratave të konsulencës, ata do t'i komentojnë ato.

## 3. Dhënia e kontratave për mallrat dhe shërbimet e tjera

3.1 Kontratat për mallrat dhe të gjitha shërbimet e tjera do të jepen në bashkëpunim me konsulentin e zbatimit nëpërmjet ofertimit konkurrues ndërkombëtar.

3.2 Dokumentet e tenderit i paraqiten KfW-së për koment në kohën e duhur para publikimit të ftesës për tender. Dokumentet e tenderit do të përfshijnë një deklaram që përshtatshmëria e ofertuesve, ndërmjet të tjerave, do t'i nënshtrohen verifikimit të Bashkimit Europian (BE) bazuar në sistemin e brendshëm të BE-së për paralajmërimin paraprak.

3.3 Periudha e ofertimit përcaktohet në një mënyrë të tillë që t'u mundësojë ofertuesve kohë të mjaftueshme për të përgatitur ofertat e tyre.

3.4 Hollësitë e mbetura në lidhje me procedurën e dhënies dhe dispozitat kontraktuale janë të shpjeguara tek "Udhëzimet për prokurimin e furnizimit dhe kontratat e punës sipas bashkëpunimit financiar me vendet në zhvillim" (aneksi 5), që përbën pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

3.5 Në njoftimin e parakualifikimit – ose nëse nuk kryhet parakualifikim – në dokumentet e tenderit, agjencitë e zbatimit të programit ose njësia e zbatimit të programit në rastin e shërbimeve të konsulencës përkatësisht i detyron ofertuesit të paraqesin së bashku me dokumentet e parakualifikimit ose së bashku me ofertën një deklaratë angazhimi (aneksi 5, faqe 27).

3.6 Gjatë lidhjes së kontratave për mallrat dhe shërbimet që financohen nga huaja, agjencitë e zbatimit të programit respektojnë gjithashtu parimet e mëposhtme:

a) Meqenëse nga huaja nuk mund të financohen detyrimet e importit në pajtim me nenin 1.3 të marrëveshjes së huas, këto detyrime importi, nëse janë pjesë e vlerës së kontratës, përcaktohen veçmas në kontratat për mallrat dhe shërbimet në fatura.

b) Nëse pagesat e kërkueshme sipas kontratave për shërbimet dhe mallrat duhet të bëhen nga huaja, këto kontrata përfshijnë një dispozitë që parashikon që çdo rimbursim, garanci ose pagesë tjetër e kërkueshme dhe çdo pagesë siguracioni bëhet për llogari të Huamarrësit në llogarinë nr. 38 000 000 00 (IBAN DE53 5002 0400 3800 0000 00) tek KfW-ja, Frankfurt am Main (BIC: KFWIDEFF; BLZ 500 204 00), ku KfW-ja i krediton këto pagesa në llogarinë e Huamarrësit. Nëse këto pagesa bëhen në monedhën lokale, ato dërgohen tek një llogari e veçantë e agjencisë së zbatimit të programit, në vendin e agjencisë së zbatimit të programit, që mund të tërhiqet vetëm me pëlqimin e KfW-së. Këto fonde mund të ripërdoren për ekzekutimin e programit me pëlqimin e KfW-së.

3.7 Para lidhjes së kontratës për mallrat dhe shërbimet, KfW-së i jepet për koment projektkontrata e rënë dakord, e pajisur rregullisht me miratimin e konsulentit të zbatimit. Kjo zbatohet edhe për çdo marrëveshje pasuese modifikuese ose ndryshuese.

#### 4. Marrëveshjet e veçanta të zbatimit

4.1 Para kontraktimit të shërbimeve të konsulentit të zbatimit, detyrat e mëposhtme duhet të përmbushen nga ndërmarrjet e ujit: Një koncept për përshtatjen e tarifave dhe mbulimin e shpenzimeve zhvillohet ose përditësohet përkatësisht dhe aprovohet nga bordi mbikëqyrës i ndërmarrjeve të ujit dhe i paraqitet rregullatorit (ERRU).

4.2 Para tenderimit të mallrave dhe shërbimeve të tjera, një audit i jashtëm ka certifikuar që UK Berat, Kuçova ka arritur 80% të mbulimit të kostos duke përfshirë shërbimin e borxhit, UK Fier ka arritur 90% të mbulimit të kostos duke përfshirë shërbimin e borxhit (përveç tenderit të matësve të jashtëm të ujit), departamenti i ujit i bashkisë së Kamzës ka arritur 55% të mbulimit të kostos, UK Lushnja ka arritur 65% të mbulimit të kostos dhe UK Saranda ka arritur 70% të mbulimit të kostos.

4.3 Para kontraktimit të mallrave dhe shërbimeve, është aprovuar një propozim për rritjen e tarifës nga bashkitë përkatëse dhe i është paraqitur rregullatorit (ERRU) që tregon qartësisht se UK Berat Kuçova mund të arrijë 100% të mbulimit të kostos duke përfshirë shërbimin e borxhit në vitin pasues, UK Fier mund të arrijë 95% të mbulimit të kostos duke përfshirë shërbimin e borxhit (përveç tenderit për matësit e jashtëm të ujit) në vitin pasues, departamenti i ujit i bashkisë së Kamzës mund të arrijë 100% të mbulimit të kostos në vitin pasues, UK Lushnja mund të arrijë 75% të mbulimit të kostos në vitin pasues dhe UK Saranda mund të arrijë 90% të mbulimit të kostos në vitin pasues.

4.4 Për më tepër ndërmarrjet e ujit do të zbatojnë masat e mëposhtme, me qëllim që të ngrenë normën e mbulimit të kostos:



#### Berat – Kuçova:

- Rritje e tarifës vjetore në furnizimin me ujë dhe kanalizimet për ekonomitë shtëpiake/shoqëritë private/institucionet publike me të paktën 20% / 10% / 10% në vitin 2012 dhe në vitin 2013;

- Rritje e vazhdueshme e tarifës vjetore për furnizimin me ujë dhe kanalizime për të gjithë grupet e klientëve me të paktën 2%, duke filluar në vitin 2014;

- Efikasitet i përmirësuar i faturimit dhe efijencë e stabilizuar në arkëtime.

#### Fier:

- Rritje e tarifës vjetore në furnizimin me ujë me të paktën 16% / 6% / 10% për ekonomitë shtëpiake/shoqëritë private/institucionet publike në vitin 2012 dhe në vitin 2013;

- Rritje vjetore e tarifës për kanalizimet për ekonomitë shtëpiake/shoqëritë private/institucionet publike me të paktën 35% / 18% / 25% në secilin prej dy viteve në vazhdim;

- Rritje e vazhdueshme e tarifës vjetore për furnizimin me ujë dhe kanalizime për të gjithë grupet e klientëve me të paktën 5%, duke filluar në vitin 2014;

- Efikasitet i përmirësuar arkëtimi në të paktën 85 %;

- Efikasitet i përmirësuar i faturimit dhe llogari-mbajtje dhe komunikimi me klientët;

- Instalim i të paktën 25 000 matësve të ujit.

#### Kamzë:

- Rritje e tarifës vjetore në furnizimin me ujë dhe kanalizimet për ekonomitë shtëpiake me të paktën 5% në vitin 2012, në vitin 2013 dhe në vitin 2014 dhe rritje e mëtejshme e tarifës sapo të jetë rritur norma e lidhjes;

- Sistem transparent për llogari-mbajtjen në lidhje me ujin dhe kanalizimet që është e ndarë brenda administratës bashkiake;

- Stabilizimi i efijences së arkëtimeve;

- Efikasitet i përmirësuar i faturimit dhe llogari-mbajtje dhe komunikim me klientët.

#### Lushnjë:

- Rritje e tarifës vjetore në furnizimin me ujë për ekonomitë shtëpiake/shoqëritë private/institucionet publike me të paktën 20% / 15% / 10% në vitin 2012, në vitin 2013 dhe në vitin 2014;

- Rritje vjetore e tarifës për kanalizimet për ekonomitë shtëpiake me të paktën 10% në vitin 2012, në vitin 2013 dhe në vitin 2014,

- Rritje e vazhdueshme e tarifës vjetore për furnizimin me ujë dhe kanalizime për të gjithë grupet e klientëve me të paktën 5%, duke filluar në vitin 2015;

- Efikasitet i përmirësuar në faturim dhe arkëtim.

#### Sarandë:

- Rritje vjetore e tarifës për furnizimin me ujë prej të paktën 15% për ekonomitë shtëpiake dhe të paktën 10% për shoqëritë private dhe institucionet publike në vitin 2012, në vitin 2013 dhe në vitin 2014,

- Rritje e vazhdueshme e tarifës vjetore për furnizimin me ujë për të gjithë grupet e klientëve me të paktën 5%, duke filluar në vitin 2015;

- Normë e përmirësuar e faturimit dhe arkëtitimit, veçanërisht për turistët sezonalë dhe fshatrat rrethues, që tarifohen për furnizim me shumicë.

4.5 Ministria e Punëve Publike dhe Transportit siguron fondet për rimbursimin e TVSH-së dhe detyrimeve doganore nga buxheti i tyre vjetor.

#### 5. Dispozitat për operimin e duhur të programit

5.1 Për të siguruar operimin e duhur të programit, njësia e zbatimit të programit paraqet një koncept operimi dhe mirëmbajtjeje të përpiluar në bashkëpunim me ndërmarrjet e ujit dhe konsulentin e zbatimit të paktën gjashtë muaj para autorizimit të investimit sipas programit.

5.2 Në të njëjtën kohë, agjencitë e zbatimit të programit i paraqesin KfW-së një parashikim financiar të përpiluar në pajtim me konsulentin e zbatimit për zonën e operimit në të cilin ndodhen nënprojektet. Ky parashikim duhet të tregojë që financimi për operimin është i siguar. Agjencitë e zbatimit të programit përditësojnë periodikisht këtë parashikim dhe sigurojnë që çdo boshllëk financiar të mbulohet në kohën e duhur. Agjencitë e zbatimit të programit ia transmetojnë KfW-së pa vonesë këtë parashikim financiar, si dhe versionet e tij të rishikuara.

#### 6. Caktimi i një auditi

6.1 Një audit vjetor për përdorimin e Kontributit Financiar të dhënë nga Bashkimi European (auditi) kryhet sipas këtij programi. KfW-ja dhe Ministria e Financave rishikojnë nëse auditi mund të kryhet nga auditi i përzgjedhur nga Ministria e Financave.

6.2 Auditi përzgjidhet pas ofrimit konkurrues ndërkombëtar dhe certifikon çdo vit përdorimin e duhur të Kontributit Financiar të dhënë nga Bashkimi European deri në përfundimin e programit.

6.3 Auditimi i kontributit financiar të dhënë nga Bashkimi European do të financohet nga kontributi financiar.

6.4 Termet e referencës për auditin do të bazohen në termat standarde të referencës së KfW-së që do t'i paraqiten KfW-së para caktimit të auditit.

### III. Lista e mallrave dhe shërbimeve dhe procedura e disbursimit

#### 1. Lista e mallrave dhe shërbimeve

1.1 Lista e mallrave dhe shërbimeve që do të financohen nga huaja përgatitet në bazë të kontratave të lidhura për këto mallra dhe shërbime. Përkatësisht, KfW-së i jepet një kopje origjinale ose e thjeshtë e secilës prej kontratave të lartpërmendura dhe e çdo kontrate përkatëse ndryshuese.

1.2 Nëse një masë e programit duhet të zbatohet pa marrëveshje dhe nuk janë lidhur kontratat, KfW-ja, në mungesë të kontratave, merr një grafik të masave të planifikuara, të ndara në kategoritë kryesore të kostos (grafik i masave pa kontratë). Kostoja e shkaktuar për administrimin e përgjithshëm në lidhje me punën pa kontratë nuk duhet të përfshihet në këtë grafik të masave pa kontratë.

1.3 KfW-ja njofton njësinë e zbatimit të programit me kërkesë për shumat e huas që ka rezervuar për financim (lista e mallrave dhe shërbimeve).

#### 2. Procedura e disbursimit

Disbursimi rregullohet nga rregulloret sipas parashikimit në aneksin 6 (procedura e disbursimit) që përbën pjesë integrale të kësaj marrëveshjeje.

Kontributi financiar i dhënë nga Bashkimi European do të përdoret për të financuar kontratat për konsultim, mallra dhe shërbime që janë dhënë pas ofertimit konkurrues ndërkombëtar për nënprojektet në Berat -Kuçovë, Fier, Kamzë, Lushnjë dhe Sarandë.

Të gjitha shërbimet e konsulencës do të financohen ekskluzivisht nga fondet e BE-së. Pagesat sipas kontratave për mallrat dhe shërbimet do të disbursohen proporcionalisht nga kontributi financiar i dhënë nga Bashkimi European dhe huaja A dhe B e dhënë sipas Bashkëpunimit Financiar Gjerman për këto kontrata.

Sipas ndarjes në aneksin 3, financimi i BE-së për Kamzën i referohet BMZ-Nr. 2020 60 242, financimi i BE-së për Berat-Kuçovën, Fierin, Lushnjën dhe Sarandën i referohet BMZ-Nr. 2020 60 408.

### IV. Raportimi dhe dispozita të tjera

#### 1. Raportimi

1.1 Deri në një njoftim të dytë, njësia e zbatimit të programit i raporton KfW-së në çdo semestër mbi përparimin e programit (raporte progresi) dhe të marrëveshjeve të zbatimit të parashikuara në seksionin II.4 të kësaj marrëveshjeje dhe mbi zhvillimin e të gjitha kushteve të tjera të përgjithshme të rëndësishme. Raporti përfshin pikat e renditura në aneksin 7. Përveç kësaj, njësia e zbatimit të programit raporton për të gjitha rrethanat që mund të rrezikojnë arritjen e objektivit të



përgjithshëm, qëllimit të programit dhe rezultateve. Në momentin e përfundimit fizik dhe autorizimit të programit, por jo më vonë se mbarimi i periudhës së garancisë, njësia e zbatimit të programit paraqet një raport përfundimtar mbi masat e përmbushura. Raportet kërkohen në ditën e fundit të muajit pas çdo semestri viti (31 janar, 30 prill, 31 korrik dhe 31 tetor). Raporti i parë është i kërkueshëm më 31 korrik 2012. Raportet siglohen nga konsulenti.

1.2 Nëse njësia e zbatimit të programit ka ngarkuar konsulentin të përpilojë raportet e progresit dhe/ose raportin përfundimtar, njësia e zbatimit të programit komenton mbi raportet ose njeh aprovimin e përmbajtjes së tij duke sigluar raportet.

1.3 Pas përfundimit të programit, njësia e zbatimit të programit raporton mbi zhvillimin e tij të mëtejshëm (shihni aneksin 7 për hollësi). KfW-ja informon rregullisht njësinë e zbatimit të programit në lidhje me përfundimin e periudhës së raportimit.

## 2. Dispozita të tjera

2.1 Njësia e zbatimit të programit dhe agjencitë e zbatimit të projektit i dërgojnë KfW-së ato dokumente që janë të nevojshme për KfW-në të bëjë komente dhe aprovimet e përmendura më sipër ose në udhëzimet e bashkëlidhura, brenda një kohe të mjaftueshme për t'i dhënë mundësi të arsyeshme për shqyrtim.

2.2 Huamarrësi vendos tabela programi që përmbajnë të paktën mesazhin e mëposhtëm:

“Një projekt zhvillimi i Qeverisë së Shqipërisë, i bashkëfinancuar nga Bashkimi European dhe Republika Federale Gjermane nëpërmjet KfW-së”.

Një vulë programi e dhënë nga Ambasada Gjermane dhe logoja e Bashkimit European (dymbëdhjetë yje të verdhë në një sfond blu) vendoset në tabelën e programit.

2.3 Të gjitha automjetet dhe pajisjet e prokuruar nga konsulentët për programin do të transferohen tek njësia e zbatimit të programit pas përfundimit të programit. Prova dokumentuese për transferimin mbahet nga njësia e zbatimit të programit deri pesë vjet pas përfundimit të programit.

2.4 Njësia e zbatimit të programit siguron që të gjithë dokumentet e përgatitura nga konsulentët të përfshijnë një referencë ndaj faktit që programi të bashkëfinancohet nga Bashkimi European dhe të shfaqë logon europiane (dymbëdhjetë yje të verdhë në sfond blu). Kjo zbatohet edhe për automjetet dhe pajisjet që janë prokuruar nga konsulenti për Programin derisa të transferohen tek njësia e zbatimit të programit pas përfundimit të programit.

2.5 Njësia e zbatimit të programit do të publikojë hollësitë e mëposhtme për të gjitha kontratat që financohen sipas kësaj marrëveshjeje në faqen e saj të internetit: titullin dhe tipin e kontratës, adresën dhe shtetësinë e kontraktorit, shumën e kontratës.

2.6 Njësia e zbatimit të programit siguron që i gjithë dokumentacioni në lidhje me përgatitjen dhe zbatimin e programit të jetë i disponueshëm për auditim për të paktën pesë vjet pas përfundimit të programit. Njësia e zbatimit të programit siguron gjithashtu që Komisioni European ose përfaqësuesit e tij të jenë në gjendje të kryejnë vlerësime të programit para, gjatë ose pas përfundimit të tij.

2.7 Dispozitat e kësaj marrëveshjeje të veçantë mund të ndryshohen ose modifikohen me marrëveshje të përbashkët me shkrim të të gjithë nënshkruesve të kësaj marrëveshjeje të veçantë, përveç kur ky ndryshim ose modifikim ka të bëjë me një bashki ose agjenci zbatimi të projektit, rast në të cilin ky ndryshim duhet të bëhet vetëm me marrëveshje të përbashkët me shkrim ndërmjet Njesisë së Zbatimit të programit, KfW-së dhe Agjencisë së Zbatimit të Programit përkatës.

2.8 Secila prej agjencive të zbatimit të projektit i ofron menjëherë KfW-së, me kërkesë, të gjithë informacionin dhe dokumentet që KfW-ja kërkon për të mbushur detyrimet e saj për të parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të raportit të biznesit me agjencinë e zbatimit të projektit, që është i nevojshme për këtë qëllim.

Gjatë lidhjes dhe zbatimit të marrëveshjes së huas A, B ose marrëveshjes së financimit, përkatësisht, secila agjenci e zbatimit të projektit vepron në emër të saj dhe për llogari të saj. Në lidhje me ligjin gjerman dhe ligjin e vendit të themelimit të agjencisë së zbatimit të projektit:

a) asnjë prej burimeve ose shumave të agjencisë së zbatimit të projektit të investuara në financimin e projektit nuk është me origjinë të paligjshme dhe, veçanërisht, kjo listë nuk është shteruese, nuk lidhet me trafikimin e drogës, korrupsionin, aktivitetin e krimit të organizuar ose terrorizmin;

b) kapitali i secilës prej agjencive të zbatimit të projektit në asnjë rast nuk është me origjinë të paligjshme dhe, veçanërisht, kjo listë nuk është shteruese, nuk lidhet me trafikimin e drogës, korrupsionin, aktivitetin e krimit të organizuar ose terrorizmin;

c) asnjë prej agjencive të zbatimit të projektit nuk përfshihet në përfitim, zotërimin ose përdorimin e pasurive që janë me origjinë të paligjshme dhe veçanërisht, kjo listë nuk është shteruese, nuk lidhet me trafikimin e drogës, korrupsionin, aktivitetin e krimit të organizuar ose terrorizmin; dhe

d) asnjë prej agjencive të zbatimit të projektit nuk përfshihet në financimin e terrorizmit.

Jeni të lutur të konfirmoni pëlqimin tuaj për marrëveshjen e mësipërme, duke nënshkruar në një mënyrë ligjërishit detyruese dhe duke kthyer kopjet e bashkëlidhura.

Ne bashkëlidhim një kopje të kësaj letre me kërkesën për t'ua transmetuar në kohën e duhur bashkive të Beratit, Fierit, Kamzës, Kuçovës, Lushnjës dhe Sarandës.

Jeni të lutur gjithashtu të transmetoni një kopje të kësaj letre në kohën e duhur tek konsulenti.

Me respekt

**KfW**

Nga	----	Nga	---
Emri	----	Emri	----
Titulli	----	Titulli	----

Lexuar dhe rënë dakord:

Tiranë, ----

**Republika e Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave (Huamarrësi)**

Nga	---
Emri	Ridvan Bode
Titulli	Ministër i Financave

**Ministria e Punëve Publike dhe Transportit**

Nga	---
Emri	Sokol Olldashi
Titulli	Ministër i Punëve Publike dhe Transportit

**Ndërmarrja e Ujit, Berat-Kuçovë**

Nga	----
Emri	----
Titulli	----

**Ndërmarrja e Ujit, Fier**

Nga	---
Emri	----
Titulli	----

**Bashkia Kamëz**

Nga	----
Emri	----
Titulli	----

**Ndërmarrja e Ujit, Lushnjë**

Nga	---
Emri	----
Titulli	----





### **Ndërmarrja e Ujit, Sarandë**

Nga ----  
Emri ----  
Titulli ----

### **ANEKSE**

- Aneksi 1: Objektivat dhe rezultatet e programit dhe supozimet për arritjen e tyre  
Aneksi 2: Grafiku kohor  
Aneksi 3: Kostoja totale dhe financimi  
Aneksi 4: Udhëzime për caktimin e konsulentëve në bashkëpunimin financiar me vendet në zhvillim  
Aneksi 5: Udhëzime për prokurimin e kontratave të furnizimit dhe punëve sipas bashkëpunimit financiar me vendet në zhvillim  
Aneksi 6: Procedura e disbursimit  
Aneksi 7: Përmbajtja dhe forma e raportimit

Aneksi 1

### **PROGRAM I INFRASTRUKTURËS BASHKIAKE II HOLLËSI TË PROGRAMIT**

#### **GRAFIK**

Objektivi i përgjithshëm i politikës së zhvillimit Përdorimi me efikasitet të burimeve ujore dhe mbrojtja e mjedisit me përmirësimin paralel të kushteve të jetesës, punës dhe shëndetësore për popullatën
---

Objektivi i programit Furnizim i sigurt dhe higjienikisht i sigurt me ujë për popullatën e qyteteve të programit me mbulim kostoje dhe tarifa të përballueshme, si dhe sigurimi i një higjiene të përshtatshme nëpërmjet shkarkimit të ujërave të zeza	Treguesit e objektivit të programit
---	-------------------------------------

Objektivi i projektit Furnizim i sigurt dhe higjienikisht i sigurt me ujë për popullatën e qyteteve të programit dhe funksionim i përmirësuar i ndërmarrjes së ujit	Treguesit e objektivit të projektit
--	-------------------------------------

<b>Rezultati 1</b>	<b>Rezultati 2</b>	<b>Rezultati 3</b>	<b>Rezultati 4</b>	<b>Rezultati 5</b>
Ulja e humbjeve teknike dhe administrative	Ulja e konsumit të energjisë	Lidhja e klientëve shtesë/të ligjshëm	Situata e përmirësuar e shkarkimit të kanalizimeve	Funksionim i përmirësuar i ndërmarrjeve me ulje kostoje dhe rritje të ardhurash
Zëvendësimi i rrjetit të shpërndarjes në zonën e qytetit (Berat-Kuçovë, Fier, Lushnjë, Sarandë)	Zhvillimi i sistemeve me rënie të lirë në vend të sistemeve me pompa: Tubacioni nga burimet/digat (Berat-Kuçova, Kamzë, Sarandë)	Zëvendësimi / zgjerimi i rrjetit të shpërndarjes (Berat-Kuçovë, Kamzë, Sarandë, Fier)	Rehabilitimi i rrjetit ekzistues të kanalizimeve (Fier)	Rritje e tarifave të rëna dakord në të gjitha bashkitë
Prokurimi dhe instalimi i matësve të ujit (Berat-Kuçovë, Kamza, Lushnjë, Sarandë)			Rrethimi i zonës për impiantin e trajtimit të ujërave të zeza (Berat-Kuçovë, Fier, Lushnjë)	Ulja e personelit / 1000 lidhje (Berat – Kuçovë, Fier, Kamzë, Lushnjë)
Prokurimi i pajisjeve operacionale (Berat-Kuçovë, Lushnjë, Kamzë, Sarandë)				Rritje e efikasitetit së arkëtimit në të gjitha bashkitë



GRAFIK KOHOR								
PROGRAMI I INFRASTRUKTURËS BASHKIAKE II, SHQIPËRI								
Nr	Emri i aktivitetit	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
1	Përgatitja	←→						
2	Zgjedhja e konsulentit të zbatimit	■						
3	Projektimi dhe tenderimi	←→						
4	Berat / Kuçovë		←→					
5	Dokumente të detajuara të projektimit dhe tenderit		■					
6	Tenderimi dhe dhënie e kontratës			■				
7	Fier	←→						
8	Dokumente të detajuara të projektimit dhe tenderit	■						
9	Tenderimi dhe dhënie e kontratës		■					
10	Kamza		←→					
11	Dokumente të detajuara të projektimit dhe tenderit		■					
12	Tenderimi dhe dhënie e kontratës			■				
13	Lushnja		←→					
14	Dokumente të detajuara të projektimit dhe tenderit		■					
15	Tenderimi dhe dhënie e kontratës			■				
16	Saranda	←→						
17	Dokumente të detajuara të projektimit dhe tenderit	■						
18	Tenderimi dhe dhënie e kontratës		■					
19	Ndërtim		←→					
20	Ndërtim Berat / Kuçovë			■				
21	Ndërtim Fier		■					
22	Ndërtim Kamza			■				
23	Ndërtim Lushnja			■				
24	Ndërtim Saranda		■					
25	Punime të mbetura					■		
26	Periudha e përgjegjësisë së defekteve				■			
Projekti 26096 PV_plan kohor 2 Datë 14.7.11								

**KOSTOJA DHE FINANCIMI I PROGRAMIT TË INFRASTRUKTURËS BASHKIAKE II**

Rezultatet/masat e projektit	Kostoja	Huaja e KfW-së, totali	Granti i BE-së, totali	IPA 2010	IPA 2009
<b>Lushnja</b>					
Furnizimi me ujë	2.725.000	1.423.389	1.301.611	1.301.611	
Kanalizimet/shkarkimet/të tjera	410.000	214.161	195.839	195.839	
Shërbime konsulence, zbatimi	310.000		310.000	310.000	
Shërbime konsulence, fuqizim institucional	200.000		200.000	200.000	
Masa emergjence	311.000	162.449	148.551	148.551	
<b>Totali Lushnjë</b>	<b>3.956.000</b>	<b>1.800.000</b>	<b>2.156.000</b>	<b>2.156.000</b>	
<b>Berat dhe Kuçovë</b>					
Furnizimi me ujë	7.565.000	4.165.847	3.399.153	3.399.153	
Kanalizimet/shkarkimet/të tjera	220.000	121.148	98.852	98.852	
Shërbime konsulence, zbatimi	771.000		771.000	771.000	
Shërbime konsulence, fuqizim institucional					
Masa emergjence	750.000	413.005	336.995	336.995	
<b>Totali Berat dhe Kuçovë</b>	<b>9.306.000</b>	<b>4.700.000</b>	<b>4.606.000</b>	<b>4.606.000</b>	
<b>Saranda</b>					
Furnizimi me ujë	4.010.000	454.649	3.555.351	3.555.351	
Kanalizimet/shkarkimet/të tjera					
Shërbime konsulence, zbatimi	400.000		400.000	400.000	
Shërbime konsulence, fuqizim institucional	100.000		100.000	100.000	
Masa emergjence	400.000	45.351	354.649	354.649	
<b>Totali Saranda</b>	<b>4.910.000</b>	<b>500.000</b>	<b>4.410.000</b>	<b>4.410.000</b>	
<b>Fier</b>					
Furnizimi me ujë	2.050.000	253.086	1.796.914	1.796.914	
Kanalizimet/shkarkimet/të tjera	1.630.000	201.235	1.428.765	1.428.765	
Shërbime konsulence, zbatimi	370.000		370.000	370.000	
Shërbime konsulence, fuqizim institucional	Përfshirë në MIP I		Përfshirë në MIP I	Përfshirë në MIP I	
Masa emergjence	370.000	45.679	324.321	324.321	



<b>Totali Fier</b>	<b>4.420.000</b>	<b>500.000</b>	<b>3.920.000</b>	<b>3.920.000</b>	
<b>Kamza</b>					
Furnizimi me ujë	9.800.000	5.822.500	3.977.500		3.977.500
Kanalizimet/shkarkimet/të tjera					
Shërbime konsulence, zbatimi	1.000.000		1.000.000		1.000.000
Shërbime konsulence, fuqizim institucional	300.000		300.000		300.000
Masa emergjence	790.000	677.500	112.500		112.500
<b>Totali Kamza</b>	<b>11.890.000</b>	<b>6.500.000</b>	<b>5.390.000</b>		<b>5.390.000</b>
<b>Faza e plotë e investimeve</b>	<b>34. 482.000</b>	<b>14.000.000</b>	<b>20.482.000</b>	<b>15.092.000</b>	<b>5.390.000</b>
<b>Huaja e zhvillimit të KFW-së</b>		<b>12.000.000</b>			
<b>Huaja e butë e KFW-së</b>		<b>2000.000</b>			

*Shënim.* Sipas parashikimit në procesverbalin e mbledhjes së çdo nënprojekti, investimet për prokurimin dhe instalimin e matësve të ujit deri në një shumë totale prej 1 685 000 euro (në lidhje me Kamzën duhet të përditësohet në pajtim me nenin I.4).

Aneksi 4

UDHËZIMET PËR CAKTIMIN E KONSULENTËVE NË BASHKËPUNIMIN FINANCIAR ME  
VENDET NË ZHVILLIM

Lidhja tek udhëzimet:

<http://www.kfw-entwicklungsbank.de/EN> Home/Service/Online Library/Gudlines/jsp



**UDHËZIMET PËR PROKURIMIN E KONTRATAVE TË FURNIZIMIT DHE PUNËVE SIPAS  
BASHKËPUNIMIT FINANCIAR ME VENDET NË ZHVILLIM**

Lidhja tek udhëzimet:

<http://www.kfw-entwicklungsbank.de/EN> Home/Service/Online Library/Gudlines/jsp

Procedura e disbursimit  
Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë  
Programi “Infrastruktura bashkiake II”  
12 milionë euro (Marrëveshja e huas A)  
BMZ-Nr 2010 65 705

2 milionë euro (Marrëveshja e huas B)  
BMZ-Nr 2010 66 315

20 482 000 euro (kontributi financiar)  
BMZ-Nr 2020 60 408 dhe BMZ-Nr 2020 60 242

#### HYRJE

Ky aneks parashikon procedurën e disbursimit për projektin/programin e sipërpërmendur. Marrëveshja e veçantë, duke përfshirë këtë aneks, i ofrohet të gjithë stafit të huamarrësit, përfituesit ose njësisë së zbatimit të programit (pala e autorizuar) dhe çdo pale tjetër të përfshirë me disbursimet, që janë ndërmarrjet e ujit UK Berat – Kuçovë, UK Fier, UK Lushnjë, UK Sarandë dhe departamenti i ujit të bashkisë së Kamzës (së bashku “Agjencitë e zbatimit të projektit”, secila një “Agjenci e zbatimit të projektit”).

KfW-ja disburson huatë dhe kontributin e pashlyeshëm financiar (fondet) me kërkesën e palës së autorizuar, në pajtim me progresin e projektit/programit të financuar. KfW-ja mbikëqyr përdorimin kontraktual të fondeve që ka rezervuar për mallra dhe shërbime specifike në bazë të “Marrëveshjes së veçantë” në lidhje me marrëveshjen e huas/financimit /projektit /programit. Lista e mallrave dhe shërbimeve si dhe fondet përkatëse të rezervuara formojnë kuadrin brenda të cilit pala e autorizuar mund të kërkojë disbursimin nga KfW-ja, nëse janë përmbushur të gjitha parakushtet për disbursimin.

#### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Të gjitha aplikimet për tërheqje

- Tregojnë numrin e referencës së KfW-së,

- Numërtohen në mënyrë të njëpasnjëshme, dhe

- Nënshkruhen nga përfaqësuesit e palës së autorizuar që janë caktuar si të autorizuar kundrejt KfW-së dhe për të cilët KfW-ja ka marrë ekzemplarët e nënshkrimeve (shembull, shihni shtojcën A).

Në përgjithësi, KfW-ja pranon vetëm kërkesat fillestare për tërheqje. Nëse, në raste të veçanta, një kërkesë për tërheqje është transmetuar me faks, origjinali duhet të dërgohet menjëherë me postë më pas, i shënuar si konfirmim faksi. KfW-ja lirohet nga pala e autorizuar nga detyrimi për çdo dëm që rezulton nga transmetimi i gabuar, veçanërisht për shkak të gabimeve, abuzimit, keqkuptimeve ose gabimeve në transmetim.

Për pagesat e bëra në një monedhë të ndryshme nga ajo e caktuar (monedhë e huaj), KfW-ja i debiton Huamarrësit ose përfituesit atë shumë që është shpenzuar nga KfW-ja për prokurimin e monedhës së huaj, duke përfshirë shpenzimet e rastësishme.

KfW-ja nuk është e detyruar për vonesat e shkaktuara nga institucionet bankare transmetuese në disbursimin ose dërgimin e fondeve. Nëse shkaktohet ndonjë vonesë nga KfW-ja, detyrimi i saj kufizohet në pagesën e interesit të mbledhur.

#### DISPOZITAT E VEÇANTA

Pala e autorizuar është Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (MPPT)

Procedura që duhet të zbatohet





Fondet e caktuara për mallrat dhe shërbimet e specifikuar në marrëveshjen e veçantë I.1. + I.3 Konsultimi disbursohen në pajtim me procedurën e disbursimit të drejtpërdrejtë.

Fondet e caktuara për mallrat dhe shërbimet e specifikuar në marrëveshjen e veçantë I.1. + I.3 Investimi disbursohen në pajtim me procedurën e thjeshtuar të disbursimit të drejtpërdrejtë.

Të gjitha shërbimet e konsulencës financohen ekskluzivisht nga fondet e BE-së. Pagesat sipas kontratës së mallrave dhe shërbimeve disbursohen proporcionalisht nga kontributi financiar i dhënë nga Bashkimi Europian dhe marrëveshja e huas A dhe marrëveshja e huas B të dhënë sipas Bashkëpunimit Financiar Gjerman për këto kontrata.

Procedura e disbursimit të drejtpërdrejtë (konsulenti)

Pala e autorizuar i dërgon KfW-së një kërkesë tërheqjeje të nënshkruar rregullisht (shihni shtojcën B), duke treguar emrin e përfituesit dhe udhëzimet e pagesës (hollësi të plota bankare).

Dokumentet në mbështetje të kërkesës për tërheqje, sipas rastit:

- Kopja e faturës së konsulentit;

- Prova për bazat e rëna dakord në kontratë për llogaritjen e çmimit në rastin e rritjes së çmimeve;

- Lista e shpenzimeve për koston e rimbursueshme që tregon datën, përshkrimin, çmimin, kursin e këmbimit të shpenzimit, të nënshkruara rregullisht nga konsulenti që tregon se informacioni i dhënë është i vërtetë dhe i saktë.

Dokumentet

Të gjitha dokumentet origjinale të shpenzimeve që i korrespondojnë faturës duhet të mbahen të paktën pesë vjet pas përfundimit të masave të financuara dhe duhet të jenë të inspektueshme në çdo rast nga KfW-ja ose palët e treta të informuara për këtë nga KfW-ja (p.sh., auditët) ose i dërgohen me kërkesë KfW-së ose palëve të treta të autorizuar nga KfW-ja.

Procedura e thjeshtuar e disbursimit të drejtpërdrejtë

Pala e autorizuar i dërgon KfW-së një kërkesë tërheqjeje të nënshkruar rregullisht të certifikuar nga konsulenti (shihni shtojcën C), që tregon emrin e përfituesit dhe udhëzimet për pagesë (hollësi të plota bankare) dhe i bashkëlidh një kopje të faturës së kontraktorit.

KfW-ja disburson fondet në llogarinë e palës së autorizuar drejtpërdrejt tek kontraktorët e mallrave dhe shërbimeve që financohen nga KfW-ja.

Siç bihet dakord në kontratën e konsulencës, konsulenti i jep palës së autorizuar një “Certifikatë pagesë” që konfirmon se janë përmbushur të gjitha parakushtet për disbursim dhe janë paraqitur të gjitha dokumentet (duke përfshirë garancitë), në pajtim me kushtet e kontratës dhe rregulloren/standardet e KfW-së.

Dokumentet

Të gjitha dokumentet origjinale të shpenzimeve që i korrespondojnë faturës duhet të mbahen të paktën pesë vjet pas përfundimit të masave të financuara dhe duhet të jenë të inspektueshme në çdo rast nga KfW-ja ose palët e treta të informuara për këtë nga KfW-ja (p.sh., auditët) ose i dërgohen me kërkesë KfW-së ose palëve të treta të autorizuar nga KfW-ja. Këto dokumente përfshijnë faturat, dokumentet e dërgesës, protokollat e pranimit dhe të gjitha dokumentet e nevojshme për të provuar pagesën.

Njoftimet e debisë do të shpërndahen automatikisht tek të adresuarit e marrëveshjes së veçantë dhe tek palët e tjera të përfshira, siç i komunikohen KfW-së nga pala e autorizuar.

Jeni të lutur të kontaktoni titullarin e KfW-së të përmendur më sipër, nëse keni pyetje në lidhje me procedurën e disbursimit, duke cituar numrin e referencës së KfW-së.

SHTOJCA

- A) Shembull i një letre që cakton nënshkruesit e autorizuar
- B) Formular kërkesë tërheqjeje procedurë e disbursimit të drejtpërdrejtë konsulentë
- C) Formular kërkesë tërheqjeje procedurë e thjeshtuar e disbursimit të drejtpërdrejtë

SHTOJCA A

SHEMBULL I NJË LETRE QË CAKTON NËNSHKRUESIT E AUTORIZUAR

Nga: \_\_\_\_\_

Pala e përfaqësuesit të autorizuar sipas marrëveshjes së huas/financimit/projektit/programit

Drejtuar:

KfW Bankengruppe

Në vëmendje të: LEa4

Postfach 11 11 41

60046 Frankfurt am Main

Republika Federale e Gjermanisë

Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë

Programi “Infrastruktura bashkiake II”

12 milionë euro (Marrëveshja e huas A)

BMZ-Nr 2010 65 705

2 milionë euro (Marrëveshja e huas B)

BMZ-Nr 2010 66 315

20 482 000 euro (Kontributi financiar)

BMZ-Nr 2020 60 408 dhe BMZ-Nr 2020 60 242

I/E nderuar zotëri/zonjë,

Në lidhje me marrëveshjen e huas/financimit/projektit/programit për projektin/programin e përmendur më sipër, ne do të donim t’ju informojmë se një prej personave, ekzemplari i nënshkrimit të të cilit shfaqet në këtë letër, është i autorizuar të nënshkruajë kërkesat për tërheqje në emër të huamarrësit/përfituesit/projektit/agjencisë së zbatimit të programit.

a) Emri:

Funksioni:

Ekzemplari:

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

b) Emri:

Funksioni:

Ekzemplari:

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_



c) Emri:  
Funksioni:  
Ekzemplari:  
Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Të gjitha njoftimet e mëparshme (sipas rastit) që japin nënshkrimet e zyrtarëve të autorizuar për të nënshkruar kërkesat për tërheqje sipas kësaj huaje/kontributi financiar, revokohen.

Me respekt

\_\_\_\_\_  
*Nënshkrimi i përfaqësuesit të autorizuar të marrëveshjes së huas/financimit/projektit/programit  
Datë*

Shënim. Në rast se çdo kërkesë duhet të nënshkruhet nga më shumë se një zyrtar, autorizimi duhet ta përcaktojë këtë qartë. Nëse nënshkruesit e autorizuar ndahen në dy grupe dhe kërkohet nënshkrimi i përbashkët, kjo duhet gjithashtu të përcaktohet qartë.

#### SHTOJCA B

Nga:

\_\_\_\_\_  
*(Adresa, pala e autorizuar)*

\_\_\_\_\_  
*(Datë)*

KfW Bankengruppe  
TM a 4  
Charlottenstrasse 33/33a  
10117 Berlin  
Republika Federale e Gjermanisë

Lënda: TM a - Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë  
Programi "Infrastruktura bashkiake II"  
12 milionë euro (Marrëveshja e huas A)  
BMZ-Nr 2010 65 705

2 milionë euro (Marrëveshja e huas B)  
BMZ-Nr. 2010 66 315

20 482 000 euro (Kontributi financiar)  
BMZ-Nr. 2020 60 408 dhe BMZ-Nr. 2020 60 242

Kërkesë për tërheqje nr. ....  
Procedura e disbursimit të drejtpërdrejtë (konsulenti)

Në pajtim me kontratat e specifikuara më poshtë, kopje të të cilave u janë dërguar, shërbimet e mëposhtme u janë dhënë rregullisht dhe duhet të paguhen:

Nr. i artikullit	Kontrata e konsulencës Datë ..... me .....	Faturë konsulenti Nr. .... Datë .....	Monedha/shuma

\* Zëri “Lista e mallrave dhe shërbimeve”

Sipas “Listës së mallrave dhe shërbimeve”, shumat e mëposhtme të pagesave të kërkueshme do të paguhen nga huaja/kontributi financiar, që ne kërkojmë ta disbursoni si më poshtë:

Monedha/shuma  
.....

Përfituesi (emri dhe adresa e shoqërisë)  
.....

Nr i llogarisë ..... IBAN (sipas rastit)  
Emri i bankës: ..... kodi BIC .....  
Banka korrespondente<sup>1</sup>: ..... kodi BIC .....

Si dokumente mbështetëse është bashkëlidhur një kopje e faturës përkatëse, nëse është e zbatueshme, së bashku me prova të bazave kontraktuale të rëna dakord për rritjen e çmimit, listën e shpenzimeve për artikujt e rimbursueshëm.

Jemi në pritje të njoftimeve të debive për disbursimet e bëra nga ana juaj.

.....  
(Nënshkrimi i palës së autorizuar)

Nga:

\_\_\_\_\_  
(Adresa, pala e autorizuar)

\_\_\_\_\_  
(Datë)

KfW Bankengruppe  
TM a 4  
Charlottenstrasse 33/33a  
10117  
Republika Federale e Gjermanisë

Lënda: TM a - Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë  
Programi “Infrastruktura bashkiake II”  
12 milionë euro (Marrëveshja e huas A)

<sup>1</sup> Përveç kësaj, nëse banka e pritësit nuk ndodhet në vendin e monedhës së pagesës, duhet të jepet emri dhe adresa e korrespondentit të bankës në atë vend. Kërkojen kërkesa të veçanta për çdo monedhë.



BMZ-Nr. 2010 65 705  
2 milionë euro (Marrëveshja e huas B)  
BMZ-Nr. 2010 66 315  
20 482 000 euro (Kontributi financiar)  
BMZ-Nr 2020 60 408 dhe BMZ-Nr. 2020 60 242

Kërkesë për tërheqje nr. ....  
Procedura e thjeshtuar e disbursimit të drejtpërdrejtë

Në pajtim me kontratat e specifikuar më poshtë, kopje të të cilave u janë dërguar, shërbimet e mëposhtme u janë dhënë rregullisht dhe duhet të paguhen:

Nr. i artikullit	Kontrata për mallrat dhe shërbimet Datë ..... me .....	Faturë Nr. .... Datë .....	Monedha/shuma

\*Zëri “Lista e mallrave dhe shërbimeve”

Sipas “Listës së mallrave dhe shërbimeve”, shumat e mëposhtme të pagesave të kërkueshme do të paguhen nga huaja/kontributi financiar, që ne kërkojmë ta disbursoni si më poshtë:

Monedha/shuma  
.....

Përfituesi (emri dhe adresa e shoqërisë)  
.....

Nr i llogarisë ..... IBAN (sipas rastit)  
Emri i bankës: ..... kodi BIC .....  
Banka korrespondente<sup>2</sup>: ..... kodi BIC .....

Si dokumente mbështetëse, bashkëlidhet një kopje e faturës përkatëse.

Konsulenti deklaron se ai ka lëshuar një “Certifikatë përkatëse” që konfirmon se shërbimet dhe furnizimet që faturohen janë kryer faktikisht, pagesa është bërë e kërkueshme dhe të gjithë dokumentet e nevojshme janë paraqitur dhe janë në pajtim me rregulloren/standartet e KfW-së.

.....  
(Nënshkrimi i përfaqësuesit të konsulentit)

Jemi në pritje të njoftimeve të debisë për disbursimet e bëra nga ana juaj.

.....  
(Nënshkrimi i palës së autorizuar)

<sup>2</sup> Përveç kësaj, nëse banka e pritësit nuk ndodhet në vendin e monedhës së pagesës, duhet të jepet emri dhe adresa e korrespondentit të bankës në atë vend. Kërkohen kërkesa të veçanta për çdo monedhë.

PËRMBAJTJA DHE FORMULARI I RAPORTIMIT

1. [emri i qytetit]

Treguesit	Njësia	Viti		
		2011	2012	2013
Sektori				
- Norma mesatare e lidhjeve, kombëtare	%			
- Norma mesatare e lidhjes në kanalizimet qendrore, kombëtare	%			
- Konsumi mesatar i ujit, kombëtar	l/c/d			
- Konsumi mesatar i ujit, zona e programit	l/c/d			
<b>Performanca e Ndërmarrjes së Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve UKKO</b>				
a. Kostoja e operimit në periudhën e raportimit -uji	lekë			
Kostoja e operimit në periudhën e raportimit - kanalizimet	lekë			
b. Prodhimi i përgjithshëm në periudhën e raportimit	m <sup>3</sup>			
c. Kostoja operationale/prodhimi total	lekë/m <sup>3</sup>			
d. Norma e popullatës së lidhur me sistemin e furnizimit me ujë	%			
e. Humbjet në ujë (të pajustificuara)	%			
f. Orët mesatare të furnizimit, urbane	h/d			
g. Norma e lidhjeve në kanalizimet e centralizuara, urbane	%			
h. Nr. i personelit (uji dhe ujërat e zeza)	Nr			
i. Nr i klientëve	Nr			
j. Nr i klientëve me matës të instaluar	Nr			
k. Shuma e faturuar në periudhën e raportimit, ujë	lekë			
l. Shuma e faturuar në periudhën e raportimit, kanalizime	lekë			
m. Shuma e arkëtuar në periudhën e raportimit, ujë	lekë			
n. Shuma e arkëtuar në periudhën e raportimit, kanalizime	lekë			
o. Efikasiteti i arkëtimit (faturuar/arkëtuar)	%			



	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
<b>I.a Të ardhura nga tarifat për m<sup>3</sup></b> (në lekë/m <sup>3</sup> pa TVSH)							
- Ujë							
Ekonomi shtëpiake							
Institucione							
Biznesi							
- Kanalizime							
Ekonomi shtëpiake							
Institucione							
Biznesi							
<b>I.a Të ardhura nga tarifat e ujit në total</b>							
<b>I.a Të ardhura nga tarifat e kanalizimeve në total</b>							
I.b Të ardhura të tjera							
I.a+b TË ARDHURA TOTALE							
<b>II. Kontribute (në lek)</b>							
- Nga bashkia							
- Nga ministria përgjegjëse							
<b>III. Përbalueshmëria</b>							
- Konsumi mesatar për ekonomi shtëpiake merret 90 lcd (në m <sup>3</sup> )							
- Fatura mesatare për ekonomitë shtëpiake për ujin dhe kanalizimet (në lek përfshirë TVSH)							
- Të ardhurat e ekonomive shtëpiake sipas nivelit kombëtar të varfërisë (INSTAT)							
- Raporti i të ardhurave të ekonomive shtëpiake të varfra, i shpenzuar për ujin dhe kanalizimet							

**LIGJ**  
**Nr. 47/2012**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS B NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, DHE KFW FRANKFURT AM MAIN PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT “INFRASTRUKTURA BASHKIAKE II, FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIMET PËR QYTETET BERAT, FIER, KAMZË, KUÇOVË, LUSHNJË DHE SARANDË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja e huas B ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e programit “Infrastruktura bashkiake II, furnizimi me ujë dhe kanalizimet për qytetet Berat, Fier, Kamzë, Kuçovë, Lushnjë dhe Sarandë”.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 26.4.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7428, datë 30.4.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

**MARRËVESHJE HUAJE B**

**DATË 20 MARS 2012 NDËRMJET KFW-SË, FRANKFURT MBI MAIN (KFW) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, TIRANË (HUAMARRËSI) PËR 2 000 000-EURO**

**PROGRAMI I INFRASTRUKTURËS BASHKIAKE II  
FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIMET PËR QYTETET E  
BERATIT, FIERIT, KAMZËS, KUÇOVËS, LUSHNJËS DHE SARANDËS  
(PROGRAMI)**

Baza për këtë marrëveshje huaje B është marrëveshja e datës 11 maj 2011 ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë mbi “Bashkëpunimin financiar 2008, 2010 për programin II të infrastrukturës bashkiake” (marrëveshje qeveritare). Një hua tjetër në shumën prej 12 milionë eurosh (huaja A) dhe një kontribut financiar i





dhënë nga Bashkimi Europian në shumën prej 20 482 000 eurosh (kontributi financiar) do të jepet nga KfW-ja në pajtim me një marrëveshje huaje (marrëveshja e huas A) dhe një marrëveshje financiare (marrëveshja e financimit) ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit:

#### Neni 1

### **Shuma dhe qëllimi i huas B**

#### 1. Huaja

1.1 KfW-ja do t'i japë Huamarrësit një hua që nuk kalon

2 000 000-euro (në fjalë: dy milionë euro) (huaja B).

1.2 Huamarrësi e kanalizon huanë B plotësisht te shoqëritë e shërbimeve komunale UK Berat-Kuçovë, UK Fier, UK Lushnjë, UK Saranda dhe te departamenti i ujit të bashkisë së Kamzës (së bashku "Agjencitë e zbatimit të programit" secila një "Agjenci e zbatimit të programit") në pajtim me kushtet e parashikuara në nenin 2. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit do të veprojë si njësi e zbatimit të programit (njësi e zbatimit të programit) për konsulentin e zbatimit. Huamarrësi merr masa që çdo agjenci e zbatimi të programit të përdorë huan B vetëm për financimin e investimeve për përmirësimin e furnizimit me ujë dhe sistemet e kanalizimeve në qytetet e Beratit, Fierit, Kamzës, Kuçovës, Lushnjës dhe Sarandës (secila një "nënprojekt", së bashku "programi"), përkatësisht dhe kryesisht për të paguar kostot e këmbimit të valutës. Njësia e zbatimit të programit, agjencitë e zbatimit të projektit dhe KfW-ja përcaktojnë hollësitë e programit, si dhe mallrat dhe shërbimet që duhet të financohen nga huaja B në një marrëveshje të veçantë që duhet të miratohet nga Huamarrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave.

1.3 Tatimet dhe taksat e tjera publike që do të krijohen nga Huamarrësi, njësia e zbatimit të programit dhe secila prej agjencive të zbatimit të programit, si dhe detyrimet doganore nuk do të financohen nga huaja B.

#### Neni 2

### **Kanalizimi i huas B tek agjencitë e zbatimit të projektit**

2.1 Përveç kur bihet dakord ndryshe sipas një politike të re të Qeverisë së Shqipërisë, me pëlqimin paraprak të KfW-së, Huamarrësi e kanalizon huanë B të përcaktuar në euro tek agjencitë e zbatimit të projektit sipas marrëveshjeve të nënhuas për një afat prej 40 vjetësh, duke përfshirë një periudhë pa pagesa prej 10 vjetësh, duke filluar nga 20 mars 2012. Interesi nuk kalon shumën totale të interesit që rrjedh nga neni 3.2.

2.2 Para disbursimit të parë nga huaja B, Huamarrësi i dërgon KfW-së një përkthim të certifikuar në anglisht ose gjermanisht të secilës prej marrëveshjeve të nënhuas të specifikuar në nenin 2.1.

2.3 Kanalizimi i huas B nuk përbën përgjegjësi të ndonjë agjencie të zbatimit të projektit kundrejt KfW-së për detyrimet e pagesës sipas marrëveshjes së huas B.

#### Neni 3

### **Disbursimi**

3.1 KfW-ja disburson huanë B në pajtim me progresin e programit dhe me kërkesë të huamarrësit. Në një marrëveshje të veçantë që duhet të bihet dakord ndërmjet agjencive të zbatimit të projektit dhe njësisë së zbatimit të programit, Huamarrësi i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe KfW-ja, do të bihen dakord për procedurën e disbursimit, veçanërisht mbi provat që duhet të paraqiten nga Huamarrësi që provojnë se shumatat e kërkuara të huas përdoren për qëllimin e

parashikuar në këtë marrëveshje huaje B. Agjencitë e zbatimit të projektit duhet të demonstrojnë para çdo disbursimi, duke paraqitur të gjitha dokumentet e kërkuara që kërkesat e përcaktuara në marrëveshjen e veçantë (marrëveshjet e veçanta të zbatimit) janë përmbushur.

3.2 KfW-ja ka të dejtë të refuzojë bërjen e disbursimeve pas datës 31 dhjetor 2015.

Me kërkesën e Huamarrësit, ky afat mund të shtyhet në pajtim me aprovimin e KfW-së.

#### Neni 4

#### **Tarifa e angazhimit, interesi dhe shlyerja**

4.1 Huamarrësi do të paguajë një tarifë angazhimi të pakthyeshme prej 0.25% p.a. (me fjalë: zero pikë dy pesë për qind në vit) për shumat e padisbursuara të Huas. Tarifa e angazhimit do të llogaritet për periudhën që fillon me kalimin e një afati tre mujor pas nënshkrimit të marrëveshjes së huas B dhe që zgjat deri në atë datë kur debitohen disbursimet.

4.2 Huamarrësi paguan interesin për huan B me një normë prej 2.00% p.a. (me fjalë dy pikë zero për qind në vit) (normë fikse interesi). Interesi do të ngarkohet nga datat në të cilat debitohen disbursimet deri në datat kur shlyerjet kreditohen në llogarinë e KfW-së të specifikuar në nenin 4.9.

4.3 Huamarrësi paguan tarifën e angazhimit, interesin dhe çdo kamatëvonesë, në pajtim me nenin 4.5 çdo gjysmëviti më 30 qershor dhe 30 dhjetor për gjysmën e vitit që mbaron në atë kohë (secila “Datë pagese”). Tarifa e parë e angazhimit bëhet e kërkueshme së bashku me pagesën e parë të interesit.

4.4 Huamarrësi e shlyen huan B si më poshtë:

<b>Kësti</b>	<b>Data</b>		<b>Shuma</b>	
1	30 qershor	2022	50 000,00	euro
2	30 dhjetor	2022	50 000,00	euro
3	30 qershor	2023	50 000,00	euro
4	30 dhjetor	2023	50 000,00	euro
5	30 qershor	2024	50 000,00	euro
6	30 dhjetor	2024	50 000,00	euro
7	30 qershor	2025	50 000,00	euro
8	30 dhjetor	2025	50 000,00	euro
9	30 qershor	2026	50 000,00	euro
10	30 dhjetor	2026	50 000,00	euro
11	30 qershor	2027	50 000,00	euro
12	30 dhjetor	2027	50 000,00	euro
13	30 qershor	2028	50 000,00	euro
14	30 dhjetor	2028	50 000,00	euro
15	30 qershor	2029	50 000,00	euro
16	30 dhjetor	2029	50 000,00	euro
17	30 qershor	2030	50 000,00	euro
18	30 dhjetor	2030	50 000,00	euro
19	30 qershor	2031	50 000,00	euro
20	30 dhjetor	2031	50 000,00	euro
21	30 qershor	2032	50 000,00	euro
22	30 dhjetor	2032	50 000,00	euro
23	30 qershor	2033	50 000,00	euro
24	30 dhjetor	2033	50 000,00	euro
25	30 qershor	2034	50 000,00	euro
26	30 dhjetor	2034	50 000,00	euro
27	30 qershor	2035	50 000,00	euro



28	30 dhjetor	2035	50 000,00	euro
29	30 qershor	2036	50 000,00	euro
30	30 dhjetor	2036	50 000,00	euro
31	30 qershor	2037	50 000,00	euro
32	30 dhjetor	2037	50 000,00	euro
33	30 qershor	2038	50 000,00	euro
34	30 dhjetor	2038	50 000,00	euro
35	30 qershor	2039	50 000,00	euro
36	30 dhjetor	2039	50 000,00	euro
37	30 qershor	2040	50 000,00	euro
38	30 dhjetor	2040	50 000,00	euro
39	30 qershor	2041	50 000,00	euro
40	30 dhjetor	2041	50 000,00	euro

4.5 Nëse shlyerjet e kësteve nuk vihen në dispozicion të KfW-së, kur bëhen të kërkueshme, KfW-ja mund të rrisë normën e interesit deri në normën bazë plus 300 pikë bazë p.a. për periudhën që fillon në datën e kërkueshme dhe që përfundon në datën në të cilën këto pagesa kreditohen te llogaria e KfW-së e specifikuar në nenin 4.9. “Norma bazë” është norma e interesit e njoftuar nga Banka Qendrore Gjermane, si normë bazë e normës së aplikueshme në datën përkatëse të kërkueshme. Në rastin e pagesës së vonuar të interesit, KfW-ja mund të pretendojë kompensim. Ky kompensim nuk e kalon shumën e arritur nëse interesi është vendosur për ato kamatëvonesat në normën bazë që mbizotëron në datën e kërkueshme plus 300 pikë bazë. Këto pagesa janë menjëherë të kërkueshme me kërkesën e parë të KfW-së dhe duhet të paguhet brenda 10 ditëve bankare që përcaktohet si dita (e ndryshme nga e shtuna ose e diela) në të cilën bankat tregtare janë të hapura për biznes të përgjithshëm në Frankfurt mbi Main, Gjermani (secila “ditë bankare”).

4.6 Tarifa angazhimit, interesi dhe çdo kamatëvonesë e prapambetur në pajtim me nenin 4.5 do të llogaritet mbi bazën e një viti me 360 ditë dhe muajve me 30 ditë.

4.7 Shumat e padisbursuara ose të paguara para kohe të huas do të kreditohen në pjesë të barabarta kundrejt shlyerjes së të gjitha kësteve të mbetura, përveç kur KfW-ja, sipas zgjedhjes së saj përcakton një mënyrë tjetër kompensimi në raste të veçanta, veçanërisht në rastin e shumave me volum më të vogël pas njoftimit paraprak të Huamarrësit.

4.8 KfW-ja ka të drejtë të kreditojë, sipas zgjedhjes së saj, pagesat e marra kundrejt pagesave të kërkueshme sipas kësaj marrëveshjeje huaje B ose marrëveshjeve të tjera të huas të lidhura ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit.

4.9 Huamarrësi kryen të gjitha pagesat në euro në llogarinë e KfW-së IBAN DE09 5002 0400 3102 5608 01 të mbajtur nga KfW-ja, Frankfurt mbi Main, me referencë shtesë të datës së kërkueshme “Ref. VVVVMMDD”, ku nuk lejohet asnjë kompensim i kundërkërkesave kundrejt këtyre pagesave”.

## Neni 5

### **Pezullimi i disbursimit dhe shlyerja e parakohshme**

5.1 Huamarrësi mundet në çdo kohë:

a) duke iu nënshtruar përmbushjes së detyrimeve të tij sipas nenit 8, të anulojë çdo shumë huaje që nuk është disbursuar ende; dhe

b) të shlyejë huan B plotësisht ose pjesërisht para maturimit.

5.2 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet, përveç kur:

a) Huamarrësi nuk ka përmbushur detyrimet e veta ndaj KfW-së për të bërë pagesat kur bëhen të kërkueshme;

b) detyrimet sipas marrëveshjes së huas A, marrëveshjes së huas B, marrëveshjes së financimit ose sipas marrëveshjeve të veçanta të lidhura me këtë marrëveshje huaje B janë shkelur;

c) Huamarrësi ose një agjenci e zbatimit të projektit nuk është në gjendje të provojë që shumat e huas janë përdorur për qëllimet e parashikuara; ose

d) lindin rrethana të jashtëzakonshme që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin, ose qëllimin e programit, ose përmbushjen e detyrimeve të pagesës të marra përsipër nga Huamarrësi sipas marrëveshjes së huas B.

5.3 Nëse ka ndodhur një nga situatat e specifikuar në nenin 5.2 a) ose 5.2 b) dhe nuk është eliminuar brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, e cila është të paktën 30 ditë, KfW-ja mundet:

a) në rastet e specifikuar në nenin 5.2 a) ose 5.2 b) të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të shumave të mbetura të huas, si dhe pagesën e të gjithë interesit të mbledhur dhe të gjitha detyrimet e tjera rastësore;

b) në rastin e specifikuar në nenin 5.2 c) të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të atyre shumave të huas meqë Huamarrësi ose një agjenci e zbatimit të projektit nuk është në gjendje të provojë se është përdorur për qëllimin e parashikuar.

## Neni 6

### **Kostoja dhe detyrimet publike**

6.1 Huamarrësi i bën të gjitha pagesat që kryhen sipas kësaj marrëveshjeje huaje B, pa asnjë zbritje të taksave ose detyrimeve të tjera publike apo kostove të tjera, dhe paguan koston e transferimit dhe konvertimit që shkaktohet në lidhje me disbursimin e huas B.

6.2 Huamarrësi mbulon të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që paguhen jashtë Republikës Federale Gjermane të lidhura me përfundimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje huaje B.

## Neni 7

### **Vlefshmëria e kësaj marrëveshjeje huaje B dhe përfaqësimi**

7.1 Në kohën e duhur para disbursimit të parë, Huamarrësi i jep KfW-së prova të pranueshme për KfW-në që provojnë se Huamarrësi i ka përmbushur të gjitha detyrimet sipas ligjit të tij kushtetues dhe të tjerë për supozimin e vlefshëm të të gjithë detyrimeve të tij sipas kësaj marrëveshjeje huaje B.

7.2 Ministri i Financave dhe ata persona që caktohen prej tij ose saj për KfW-në dhe autorizohen nëpërmjet ekzemplarëve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij ose saj e përfaqësojnë Huamarrësin në zbatimin e kësaj marrëveshjeje huaje B. Drejtori i përgjithshëm i çdo agjencie të zbatimit të projektit dhe ata persona që caktohen prej tij ose saj për KfW-në dhe autorizohen nëpërmjet ekzemplarëve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij ose saj e përfaqësojnë agjencinë përkatëse të zbatimit të projektit në zbatimin e kësaj marrëveshjeje huaje B. Fuqia e përfaqësimit nuk skadon derisa anulimi shprehimisht nga përfaqësuesi i Huamarrësit të autorizuar për atë kohë të jetë marrë prej KfW-së.

7.3 Ndryshimet ose shtojcat e kësaj marrëveshjeje huaje B dhe çdo njoftim dhe deklaram i dhënë nga palët kontraktuese sipas kësaj marrëveshjeje huaje B duhet të jetë me shkrim. Çdo njoftim ose deklaram i tillë konsiderohet i marrë menjëherë sapo të ketë arritur në adresën e mëposhtme të palës përkatëse kontraktuese ose në atë adresë tjetër të palës përkatëse kontraktuese siç i njoftohet palës tjetër kontraktuese:



Për KfW-në: KfW  
Departament: LEa4 – Municipal Infrastructure  
South East Europe and Turkey  
Postfach 11 11 41  
60046 Frankfurt am Main  
Federal Republic of Germany  
Faks +49 69 7431 2944

Për Huamarrësin: Ministria e Financave  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1  
Tirana  
Shqipëri  
Faks (+355) 4 222 84 94

## Neni 8 Programi

8.1 Huamarrësi, i përfaqësuar nga njësia e zbatimit të programit, merr masa vetë dhe merr gjithashtu masa që çdo agjenci e zbatimit të projektit:

a) të përgatisë, zbatojë, operojë dhe ruajë nënprojektet në pajtim me praktikën e qëndrueshme financiare dhe inxhinierike dhe thelbësisht në pajtim me konceptin e programit të rënë dakord ndërmjet njësive të zbatimit të programit, agjencive të zbatimit të projektit dhe KfW-së;

b) u cakton përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të programit konsulentëve të pavarur dhe të kualifikuar dhe zbatimin e projektit firmave të kualifikuara;

c) jep kontratat për mallrat dhe shërbimet që financohen nga huaja B me tender konkurrues ndërkombëtar paraprak;

d) siguron financim të plotë të programit dhe i jep KfW-së, me kërkesë të saj, prova që provojnë që kostoja e papaguar nga huaja B është mbuluar;

e) mban libra dhe regjistra që tregojnë qartë koston e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për programin dhe që identifikojnë qartë mallrat dhe shërbimet e financuara;

f) ndjek hapat e zbatimit të programit për përmirësimet e performancës të monitoruara rreptësisht, sipas përcaktimit në marrëveshjen e veçantë (marrëveshjet e veçanta për zbatimin). Çdo informacion i tillë duhet t’i jepet nga agjencitë e zbatimit të projektit huamarrësit dhe KfW-së;

g) mundëson që përfaqësuesit e KfW-së të jenë gjithmonë në gjendje të inspektojnë librat dhe regjistrat dhe të gjithë dokumentacionin përkatës për zbatimin dhe operimin e programit dhe për të vizituar programin dhe pikat e lidhura me të;

h) i jep KfW-së dhe merr masa që çdo informacion i tillë dhe regjistrat e programit dhe progresit të tij të mëtejshëm t’i jepet KfW-së, sipas kërkesës së KfW-së;

i) menjëherë dhe me iniciativën e tij, njofton KfW-në për çdo rrethanë që përjashton ose rrezikon seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e programit;

j) i kalon pa vonesë KfW-së çdo pyetje të marrë nga agjencitë e zbatimit të projektit nga OECD-ja ose anëtarët e saj, sipas të ashtuquajturës “Marrëveshja për transparencë të kredive të palidhura ODA”, pas dhënies së kontratave për furnizimet dhe shërbimet që duhet të financohen nga huaja B dhe bashkërendon përgjigjen për çdo pyetje të tillë me KfW-në.

8.2 Huamarrësi i përfaqësuar nga njësia e zbatimit të programit, agjencitë e zbatimit të projektit dhe KfW-ja, përcaktojnë hollësitë e nenit 8.1 me një marrëveshje të veçantë.

8.3 Për transportin e mallrave që duhet të financohen zbatohen dispozitat e parashikuara në marrëveshjen qeveritare, të cilat janë të njohura nga Huamarrësi.

Neni 9  
**Dispozita të ndryshme**

9.1 Huamarrësi siguron vetë dhe merr masa që çdo agjenci e zbatimit të projektit sigurojë që personat e ngarkuar prej tyre me përgatitjen dhe zbatimin e programit, dhënien e çdo kontrate për furnizimin dhe shërbimet që duhet të financohen dhe me kërkimin e disbursimeve të shumave të huas, të mos kërkojnë, marrin, paraqesin, ofrojnë, premtojnë ose marrin një premtim për pagesa të paligjshme ose avantazhe të tjera në lidhje me këto detyra.

9.2 KfW-ja ka të drejtë t'i japë Republikës Federale Gjermane informacion mbi përfundimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje huaje B. Si KfW-ja, ashtu edhe Republika Federale Gjermane kanë të drejtë të kalojnë informacionin mbi huan B dhe programin tek organizatat ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore, veçanërisht në lidhje me aspektet e shërbimit të borxhit.

9.3 Nëse një dispozitë e kësaj marrëveshjeje huaje A është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera mbeten të paprekura. Çdo boshllëk që rrjedh nga kjo plotësohet me një dispozitë në pajtim me qëllimin e kësaj marrëveshjeje huaje B.

9.4 Huamarrësi nuk mund të kalojë, transferojë, rëndojë me peng apo hipotekë asnjë pretendim nga kjo marrëveshje huaje B.

9.5 Të gjitha pretendimet e KfW-së sipas kësaj marrëveshje huaje B parashkruhen pesë vjet nga fundi i vitit në të cilin kanë lindur këto pretendime dhe në të cilin KfW-ja ka ardhur në dijeni të rrethanave që përbëjnë këtë pretendim ose mund të kishte ardhur në dijeni pa neglizhencë të dukshme.

9.6 Kjo marrëveshje huaje B rregullohet nga ligjet e Republikës Federale Gjermane. Vendi i përmbushjes është Frankfurt mbi Main.

9.7 Të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin nga ose në lidhje me këtë marrëveshje huaje B do të zgjidhen ekskluzivisht dhe përfundimisht nga një gjykatë arbitrazhi. Në këtë aspekt, zbatohen sa më poshtë:

a) Gjykata e arbitrazhit përbëhet nga një ose tre arbitra që emërohen dhe veprojnë në pajtim me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) të zbatueshme herë pas here.

b) Gjykimet e arbitrazhit kryhen në Frankfurt mbi Main. Gjykimet zhvillohen në gjuhën angleze.

9.8 Kjo marrëveshje huaje B nuk hyn në fuqi deri sa Huamarrësi të ketë informuar KfW-në me shkrim që marrëveshja e huas B është ratifikuar dhe ratifikimi është publikuar sipas rregullave.

Bërë në 2 kopje origjinale në gjuhën angleze.  
Tiranë, më 20 mars 2012.

**KfW**

Nga: \_\_\_\_\_  
Emri: \_\_\_\_\_  
Titulli: \_\_\_\_\_

Nga: \_\_\_\_\_  
Emri: \_\_\_\_\_  
Titulli: \_\_\_\_\_

Tiranë



**Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave**

Nga:  
Emri:                       
Titulli:                     

Ridvan Bode  
Ministër i Financave

Aneksi 1

**PROGRAM I INFRASTRUKTURËS BASHKIAKE II  
HOLLËSI TË PROGRAMIT**

**GRAFIK**

Objektivi i përgjithshëm i politikës së zhvillimit Përdorimi me efikasitet të burimeve ujore dhe mbrojtja e mjedisit me përmirësimin paralel të kushteve të jetesës, punës dhe shëndetësore për popullatën
---

Objektivi i programit Furnizim i sigurt dhe higjienikisht i sigurt me ujë për popullatën e qyteteve të programit me mbulim kostoje dhe tarifa të përballueshme, si dhe sigurimi i një higjienë të përshtatshme nëpërmjet shkarkimit të ujërave të zeza	Treguesit e objektivit të programit
---	-------------------------------------

Objektivi i projektit Furnizim i sigurt dhe higjienikisht i sigurt me ujë për popullatën e qyteteve të programit dhe funksionim i përmirësuar i ndërmarrjes së ujit	Treguesit e objektivit të projektit
--	-------------------------------------

<b>Rezultati 1</b>	<b>Rezultati 2</b>	<b>Rezultati 3</b>	<b>Rezultati 4</b>	<b>Rezultati 5</b>
Ulja e humbjeve teknike dhe administrative	Ulja e konsumit të energjisë	Lidhja e klientëve shtesë/të ligjshëm	Situata e përmirësuar e shkarkimit të kanalizimeve	Funksionim i përmirësuar i ndërmarrjeve me ulje kostoje dhe rritje të ardhurash
Zëvendësimi i rrjetit të shpërndarjes në zonën e qytetit (Berat-Kuçovë, Fier, Lushnjë, Sarandë)	Zhvillimi i sistemeve me rënie të lirë në vend të sistemeve me pompa: tubacioni nga burimet/digat (Berat-Kuçova, Kamzë, Sarandë)	Zëvendësimi / zgjerimi i rrjetit të shpërndarjes (Berat-Kuçovë, Kamzë, Sarandë, Fier)	Rehabilitimi i rrjetit ekzistues të kanalizimeve (Fier)	Rritje e tarifave të rëna dakord në të gjitha bashkitë
Prokurimi dhe instalimi i matësve të ujit (Berat-Kuçovë, Kamza, Lushnjë, Sarandë)			Rrethimi i zonës për impiantin e trajtimit të ujërave të zeza (Berat-Kuçovë, Fier, Lushnjë)	Ulja e personelit / 1000 lidhje (Berat – Kuçovë, Fier, Kamzë, Lushnjë)
Prokurimi i pajisjeve operacionale (Berat-Kuçovë, Lushnjë, Kamzë, Sarandë)				Rritje e efikasitetit të arkëtimit në të gjitha bashkitë

GRAFIK KOHOR								
PROGRAMI I INFRASTRUKTURËS BASHKIAKE II, SHQIPËRI								
Nr	Emri i aktivitetit	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
1	Përgatitja	←→						
2	Zgjedhja e konsulentit të zbatimit	■						
3	Projektimi dhe tenderimi	←→						
4	Berat / Kuçovë		←→					
5	Dokumente të detajuara të projektimit dhe tenderit		■					
6	Tenderimi dhe dhënie e kontratës			■				
7	Fier	←→						
8	Dokumente të detajuara të projektimit dhe tenderit	■						
9	Tenderimi dhe dhënie e kontratës		■					
10	Kamza		←→					
11	Dokumente të detajuara të projektimit dhe tenderit		■					
12	Tenderimi dhe dhënie e kontratës			■				
13	Lushnja		←→					
14	Dokumente të detajuara të projektimit dhe tenderit		■					
15	Tenderimi dhe dhënie e kontratës			■				
16	Saranda	←→						
17	Dokumente të detajuara të projektimit dhe tenderit	■						
18	Tenderimi dhe dhënie e kontratës		■					
19	Ndërtim		←→					
20	Ndërtim Berat / Kuçovë			■				
21	Ndërtim Fier		■					
22	Ndërtim Kamza			■				
23	Ndërtim Lushnja			■				
24	Ndërtim Saranda		■					
25	Punime të mbetura					■		
26	Periudha e përgjegjësisë së defekteve				■			
Projekti 26096 PV_plan kohor 2 Datë 14.07.11								





KOSTOJA DHE FINANCIMI I PROGRAMIT TË INFRASTRUKTURËS BASHKIAKE II

Rezultatet/masat e projektit	Kostoja	Huaja e KfW-së Totali	Granti i BE-së Totali	IPA 2010	IPA 2009
<b>Lushnja</b>					
Furnizimi me ujë	2.725.000	1.423.389	1.301.611	1.301.611	
Kanalizimet/shkarkimet/të tjera	410.000	214.161	195.839	195.839	
Shërbime konsulence, zbatimi	310.000		310.000	310.000	
Shërbime konsulence, fuqizim institucional	200.000		200.000	200.000	
Masa emergjence	311.000	162.449	148.551	148.551	
<b>Totali Lushnjë</b>	<b>3.956.000</b>	<b>1.800.000</b>	<b>2.156.000</b>	<b>2.156.000</b>	
<b>Berat dhe Kuçovë</b>					
Furnizimi me ujë	7.565.000	4.165.847	3.399.153	3.399.153	
Kanalizimet/shkarkimet/të tjera	220.000	121.148	98.852	98.852	
Shërbime konsulence, zbatimi	771.000		771.000	771.000	
Shërbime konsulence, fuqizim institucional					
Masa emergjence	750.000	413.005	336.995	336.995	
<b>Totali Berat dhe Kuçovë</b>	<b>9.306.000</b>	<b>4.700.000</b>	<b>4.606.000</b>	<b>4.606.000</b>	
<b>Sarandë</b>					
Furnizimi me ujë	4.010.000	454.649	3.555.351	3.555.351	
Kanalizimet/shkarkimet/të tjera					
Shërbime konsulence, zbatimi	400.000		400.000	400.000	
Shërbime konsulence, fuqizim institucional	100.000		100.000	100.000	
Masa emergjence	400.000	45.351	354.649	354.649	
<b>Totali Sarandë</b>	<b>4.910.000</b>	<b>500.000</b>	<b>4.410.000</b>	<b>4.410.000</b>	
<b>Fier</b>					
Furnizimi me ujë	2.050.000	253.086	1.796.914	1.796.914	
Kanalizimet/shkarkimet/të tjera	1.630.000	201.235	1.428.765	1.428.765	
Shërbime konsulence, zbatimi	370.000		370.000	370.000	
Shërbime konsulence, fuqizim institucional	Përfshirë në MIP I		Përfshirë në MIP I	Përfshirë në MIP I	

Masa emergjence	370.000	45.679	324.321	324.321	
<b>Totali Fier</b>	<b>4.420.000</b>	<b>500.000</b>	<b>3.920.000</b>	<b>3.920.000</b>	
<b>Kamëz</b>					
Furnizimi me ujë	9.800.000	5.822.500	3.977.500		3.977.500
Kanalizimet/shkarkimet/të tjera					
Shërbime konsulence, zbatimi	1.000.000		1.000.000		1.000.000
Shërbime konsulence, fuqizim institucional	300.000		300.000		300.000
Masa emergjence	790.000	677.500	112.500		112.500
<b>Totali Kamzë</b>	<b>11.890.000</b>	<b>6.500.000</b>	<b>5.390.000</b>		<b>5.390.000</b>
<b>Faza e plotë e investimeve</b>	<b>34.482.000</b>	<b>14.000.000</b>	<b>20.482.000</b>	<b>15.092.000</b>	<b>5.390.000</b>
<b>Huaja e zhvillimit të KFW-së</b>		<b>12.000.000</b>			
<b>Huaja e butë e KFW-së</b>		<b>2000.000</b>			

*Shënim.* Sipas parashikimit në procesverbalin e mbledhjes së çdo nënprojekti, investimet për prokurimin dhe instalimin e matësve të ujit deri në një shumë totale prej 1 685 000 eurosh (në lidhje me Kamzën duhet të përditësohet në pajtim me nenin I.4).



UDHËZIMET PËR CAKTIMIN E KONSULENTËVE NË BASHKËPUNIMIN FINANCIAR ME  
VENDET NË ZHVILLIM

Lidhja tek udhëzimet:

<http://www.kfw-entwicklungsbank.de/EN> Home/Service/Online Library/Gudlines/jsp

**UDHËZIMET PËR PROKURIMIN E KONTRATAVE TË FURNIZIMIT DHE PUNËVE SIPAS  
BASHKËPUNIMIT FINANCIAR ME VENDET NË ZHVILLIM**

Lidhja tek udhëzimet:

<http://www.kfw-entwicklungsbank.de/EN> Home/Service/Online Library/Gudlines/jsp



Procedura e disbursimit  
Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë  
Programi “Infrastruktura bashkiake II”  
12 milionë euro (Marrëveshja e huas A)  
BMZ-Nr. 2010 65 705  
  
2 milionë euro (Marrëveshja e huas B)  
BMZ-Nr. 2010 66 315  
  
20 482 000 euro (Kontributi financiar)  
BMZ-Nr. 2020 60 408 dhe BMZ-Nr 2020 60 242

#### HYRJE

Ky aneks parashikon procedurën e disbursimit për projektin/programin e sipërpërmendur. Marrëveshja e veçantë, duke përfshirë këtë aneks, i ofrohet të gjithë stafit të huamarrësit, përfituesit ose njësisë së zbatimit të programit (pala e autorizuar) dhe çdo pale tjetër të përfshirë me disbursimet, që janë ndërmarrjet e ujit UK Berat – Kuçovë, UK Fier, UK Lushnjë, UK Sarandë dhe departamenti i ujit të bashkisë së Kamzës (së bashku “Agjencitë e zbatimit të projektit”, secila një “Agjenci e zbatimit të projektit”).

KfW-ja disburson huat dhe kontributin e pashlyeshëm financiar (Fondet) me kërkesën e palës së autorizuar, në pajtim me progresin e projektit/programit të financuar. KfW-ja mbikëqyr përdorimin kontraktual të fondeve që ka rezervuar për mallra dhe shërbime specifike në bazë të “Marrëveshjes së veçantë” në lidhje me marrëveshjen e huas/financimit /projektit /programit. Lista e mallrave dhe shërbimeve si dhe fondet përkatëse të rezervuara formojnë kuadrin brenda të cilit pala e autorizuar mund të kërkojë disbursimin nga KfW-ja, nëse janë përmbushur të gjitha parakushtet për disbursimin.

#### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

- Të gjitha aplikimet për tërheqje
- Tregojnë numrin e referencës së KfW-së,
- Numërtohen në mënyrë të njëpasnjëshme, dhe
- Nënshkruhen nga përfaqësuesit e palës së autorizuar që janë caktuar si të autorizuar kundrejt KfW-së dhe për të cilët KfW-ja ka marrë ekzemplarët e nënshkrimeve (shembull, shihni shtojcën A).

Në përgjithësi, KfW-ja pranon vetëm kërkesat fillestare për tërheqje. Nëse, në raste të veçanta, një kërkesë për tërheqje është transmetuar me faks, origjinali duhet të dërgohet menjëherë me postë më pas, i shënuar si konfirmim faksi. KfW-ja lirohet nga pala e autorizuar nga detyrimi për çdo dëm që rezulton nga transmetimi i gabuar, veçanërisht për shkak të gabimeve, abuzimit, keqkuptimeve ose gabimeve në transmetim.

Për pagesat e bëra në një monedhë të ndryshme nga ajo e caktuar (monedhë e huaj), KfW-ja i debiton huamarrësit ose përfituesit atë shumë që është shpenzuar nga KfW-ja për prokurimin e monedhës së huaj, duke përfshirë shpenzimet e rastësishme.

KfW-ja nuk është e detyruar për vonesat e shkaktuara nga institucionet bankare transmetuese në disbursimin ose dërgimin e fondeve. Nëse shkaktohet ndonjë vonesë nga KfW-ja, detyrimi i saj kufizohet në pagesën e interesit të mbledhur.

#### DISPOZITAT E VEÇANTA

Pala e autorizuar është Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (MPPT)  
Procedura që duhet të zbatohet

Fondet e caktuara për mallrat dhe shërbimet e specifikuar në marrëveshjen e veçantë I.1. + I.3 Konsultimi disbursohen në pajtim me procedurën e disbursimit të drejtpërdrejtë.

Fondet e caktuara për mallrat dhe shërbimet e specifikuar në marrëveshjen e veçantë I.1. + I.3 Investimi disbursohen në pajtim me procedurën e thjeshtuar të disbursimit të drejtpërdrejtë.

Të gjitha shërbimet e konsulencës financohen ekskluzivisht nga fondet e BE-së. Pagesat sipas kontratës së mallrave dhe shërbimeve disbursohen proporcionalisht nga kontributi financiar i dhënë nga Bashkimi Europian dhe marrëveshja e huas A dhe marrëveshja e huas B të dhënë sipas Bashkëpunimit Financiar Gjerman për këto kontrata.

Procedura e disbursimit të drejtpërdrejtë (konsulenti)

Pala e autorizuar i dërgon KfW-së një kërkesë tërheqjeje të nënshkruar rregullisht (shihni shtojcën b), duke treguar emrin e përfituesit dhe udhëzimet e pagesës (hollësi të plota bankare).

Dokumentet në mbështetje të kërkesës për tërheqje, sipas rastit:

- Kopja e faturës së konsulentit;
- Prova për bazat e rëna dakord në kontratë për llogaritjen e çmimit në rastin e rritjes së çmimeve;
- Lista e shpenzimeve për koston e rimbursueshme që tregon datën, përshkrimin, çmimin, kursin e këmbimit të shpenzimit, të nënshkruara rregullisht nga konsulenti që tregon se informacioni i dhënë është i vërtetë dhe i saktë.

Dokumentet

Të gjitha dokumentet origjinale të shpenzimeve që i korrespondojnë faturës duhet të mbahen të paktën pesë vjet pas përfundimit të masave të financuara dhe duhet të jenë të inspektueshme në çdo rast nga KfW-ja ose palët e treta të informuara për këtë nga KfW-ja (p.sh., auditët) ose i dërgohen me kërkesë KfW-së ose palëve të treta të autorizuar nga KfW-ja.

Procedura e thjeshtuar e disbursimit të drejtpërdrejtë

Pala e autorizuar i dërgon KfW-së një kërkesë tërheqjeje të nënshkruar rregullisht të certifikuar nga konsulenti (shihni shtojcën C), që tregon emrin e përfituesit dhe udhëzimet për pagesë (hollësi të plota bankare) dhe i bashkëlidh një kopje të faturës së kontraktit.

KfW-ja disburson fondet në llogarinë e palës së autorizuar drejtpërdrejt te kontraktorët e mallrave dhe shërbimeve që financohen nga KfW-ja.

Siç bihet dakord në kontratën e konsulencës, konsulenti i jep palës së autorizuar një “Certifikatë pagese” që konfirmon se janë përmbushur të gjitha parakushtet për disbursim dhe janë paraqitur të gjitha dokumentet (duke përfshirë garancitë), në pajtim me kushtet e kontratës dhe rregulloren/standardet e KfW-së.

Dokumentet

Të gjitha dokumentet origjinale të shpenzimeve që i korrespondojnë faturës duhet të mbahen të paktën pesë vjet pas përfundimit të masave të financuara dhe duhet të jenë të inspektueshme në çdo rast nga KfW-ja ose palët e treta të informuara për këtë nga KfW-ja (p.sh., auditët) ose i dërgohen me kërkesë KfW-së ose palëve të treta të autorizuar nga KfW-ja. Këto dokumente përfshijnë faturat, dokumentet e dërgesës, protokollat e pranimit dhe të gjitha dokumentet e nevojshme për të provuar pagesën.

Njoftimet e debisë do të shpërndahen automatikisht tek të adresuarit e marrëveshjes së veçantë dhe te palët e tjera të përfshira, siç i komunikohen KfW-së nga pala e autorizuar.

Jeni të lutur të kontaktoni titullarin e KfW-së të përmendur më sipër, nëse keni pyetje në lidhje me procedurën e disbursimit, duke cituar numrin e referencës së KfW-së.



## SHTOJCA

- A) Shembull i një letre që cakton nënshkruesit e autorizuar
- B) Formular kërkesë tërheqjeje procedurë e disbursimit të drejtpërdrejtë konsulentë
- C) Formular kërkesë tërheqjeje procedurë e thjeshtuar e disbursimit të drejtpërdrejtë

## SHTOJCA A

### SHEMBULL I NJË LETRE QË CAKTON NËNSHKRUESIT E AUTORIZUAR

Nga: \_\_\_\_\_  
Pala e përfaqësuesit të autorizuar sipas marrëveshjes së huas/financimit/projektit/programit

Drejtuar:  
KfW Bankengruppe  
Në vëmendje të: LEa4  
Postfach 11 11 41  
60046 Frankfurt am Main  
Republika Federale e Gjermanisë

Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë  
Programi “Infrastruktura bashkiake II”  
12 milionë euro (Marrëveshja e huas A)  
BMZ-Nr. 2010 65 705

2 milionë euro (Marrëveshja e huas B)  
BMZ-Nr. 2010 66 315

20 482 000 euro (Kontributi financiar)  
BMZ-Nr. 2020 60 408 dhe BMZ-Nr. 2020 60 242

I/E nderuar zotëri/zonjë,

Në lidhje me marrëveshjen e huas/financimit/projektit/programit për projektin/programin e përmendur më sipër, ne do të donim t’iu informonim se një prej personave, ekzemplari i nënshkrimit të të cilit shfaqet në këtë letër, është i autorizuar të nënshkruajë kërkesat për tërheqje në emër të huamarrësit/përfituesit/projektit/agjencisë së zbatimit të programit.

a) Emri:  
Funksioni:  
Ekzemplari:  
Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

b) Emri:  
Funksioni:  
Ekzemplari:  
Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

c) Emri:  
Funksioni:  
Ekzemplari:  
Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Të gjitha njoftimet e mëparshme (sipas rastit) që japin nënshkrimet e zyrtarëve të autorizuar për të nënshkruar kërkesat për tërheqje sipas kësaj huaje/kontributi financiar, revokohen.

Me respekt

\_\_\_\_\_  
*Nënshkrimi i përfaqësuesit të autorizuar të marrëveshjes së huas/financimit/projektit/programit Datë*

Shënim. Në rast se çdo kërkesë duhet të nënshkruhet nga më shumë se një zyrtar, autorizimi duhet ta përcaktojë këtë qartë. Nëse nënshkruesit e autorizuar ndahen në dy grupe dhe kërkohet nënshkrimi i përbashkët, kjo duhet gjithashtu të përcaktohet qartë.

#### SHTOJCA B

Nga:

\_\_\_\_\_  
*(Adresa, pala e autorizuar)*

\_\_\_\_\_  
*(Datë)*

KfW Bankengruppe  
TM a 4  
Charlottenstrasse 33/33a  
10117 Berlin  
Republika Federale e Gjermanisë

Lënda: TM a - Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë  
Programi “Infrastruktura bashkiake II”  
12 milionë euro (Marrëveshja e huas A)  
BMZ-Nr. 2010 65 705

2 milionë euro (Marrëveshja e huas B)  
BMZ-Nr. 2010 66 315

20 482 000 euro (Kontributi financiar)  
BMZ-Nr. 2020 60 408 dhe BMZ-Nr. 2020 60 242

Kërkesë për tërheqje nr. ....  
Procedura e disbursimit të drejtpërdrejtë (konsulenti)





Në pajtim me kontratat e specifikuara më poshtë, kopje të të cilave u janë dërguar, shërbimet e mëposhtme u janë dhënë rregullisht dhe duhet të paguhen:

Nr. i artikullit	Kontrata e konsulencës Datë ..... më .....	Faturë konsulenti Nr. .... Datë .....	Monedha/shuma

\* Zëri “Lista e mallrave dhe shërbimeve”

Sipas “Listës së mallrave dhe shërbimeve”, shumat e mëposhtme të pagesave të kërkueshme do të paguhen nga huaja/kontributi financiar, që ne kërkojmë ta disbursoni si më poshtë:

Monedha/shuma

.....

Përfituesi (emri dhe adresa e shoqërisë)

.....

Nr. i llogarisë ..... IBAN (sipas rastit)

Emri i bankës: ..... kod i BIC .....

Banka korrespondente<sup>3</sup>: ..... kod i BIC .....

Si dokumente mbështetëse është bashkëlidhur një kopje e faturës përkatëse, nëse është e zbatueshme, së bashku me prova të bazave kontraktuale të rëna dakord për rritjen e çmimit, listën e shpenzimeve për artikujt e rimbursueshëm.

Jemi në pritje të njoftimeve të debive për disburimet e bëra nga ana juaj.

.....  
(Nënshkrimi i palës së autorizuar)

Nga:

\_\_\_\_\_  
(Adresa, pala e autorizuar)

\_\_\_\_\_  
(Datë)

KfW Bankengruppe

TM a 4

Charlottenstrasse 33/33a

10117

Republika Federale e Gjermanisë

Lënda: TM a - Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë

Programi “Infrastruktura bashkiake II”

12 milionë euro (Marrëveshja e huas A)

BMZ-Nr. 2010 65 705

<sup>3</sup> Përveç kësaj, nëse banka e pritësit nuk ndodhet në vendin e monedhës së pagesës, duhet të jepet emri dhe adresa e korrespondentit të bankës në atë vend. Kërkohen kërkesa të veçanta për çdo monedhë.

2 milionë euro (Marrëveshja e huas B)  
BMZ-Nr. 2010 66 315

20 482 000 euro (Kontributi financiar)  
BMZ-Nr. 2020 60 408 dhe BMZ-Nr. 2020 60 242

Kërkesë për tërheqje nr. ....  
Procedura e thjeshtuar e disbursimit të drejtpërdrejtë

Në pajtim me kontratat e specifikuar më poshtë, kopje të të cilave u janë dërguar, shërbimet e mëposhtme u janë dhënë rregullisht dhe duhet të paguhen:

Nr. i artikullit	Kontrata për mallrat dhe shërbimet Datë ..... me .....	Faturë Nr. .... Datë .....	Monedha/shuma

\*Zëri “Lista e mallrave dhe shërbimeve”

Sipas “Listës së mallrave dhe shërbimeve”, shumat e mëposhtme të pagesave të kërkueshme do të paguhen nga huaja/kontributi financiar, që ne kërkojmë ta disbursoni si më poshtë:

Monedha/shuma  
.....

Përfituesi (emri dhe adresa e shoqërisë)  
.....

Nr i llogarisë ..... IBAN (sipas rastit)  
Emri i bankës: ..... kodi BIC .....  
Banka korrespondente<sup>4</sup>: ..... kodi BIC .....

Si dokumente mbështetëse, bashkëlidhet një kopje e faturës përkatëse.

Konsulenti deklaron se ai ka lëshuar një “Certifikatë përkatëse” që konfirmon se shërbimet dhe furnizimet që faturohen janë kryer faktikisht, pagesa është bërë e kërkueshme dhe të gjithë dokumentet e nevojshme janë paraqitur dhe janë në pajtim me rregulloren/standardet e KfW-së.

.....  
(Nënshkrimi i përfaqësuesit të konsulentit)

Jemi në pritje të njoftimeve të debisë për disbursimet e bëra nga ana juaj.

.....  
(Nënshkrimi i palës së autorizuar)

<sup>4</sup> Përveç kësaj, nëse banka e pritësit nuk ndodhet në vendin e monedhës së pagesës, duhet të jepet emri dhe adresa e korrespondentit të bankës në atë vend. Kërkohen kërkesa të veçanta për çdo monedhë.



PËRMBAJTJA DHE FORMULARI I RAPORTIMIT

1. [emri i qytetit]

Treguesit	Njësia	Viti		
		2011	2012	2013
Sektori				
- Norma mesatare e lidhjeve, kombëtare	%			
- Norma mesatare e lidhjes në kanalizimet qendrore, kombëtare	%			
- Konsumi mesatar i ujit, kombëtar	l/c/d			
- Konsumi mesatar i ujit, zona e programit	l/c/d			
<b>Performanca e ndërmarrjes së furnizimit me ujë dhe kanalizimeve UKKO</b>				
a. Kostoja e operimit në periudhën e raportimit-ujë	lekë			
Kostoja e operimit në periudhën e raportimit – kanalizimet	lekë			
b. Prodhimi i përgjithshëm në periudhën e raportimit	m <sup>3</sup>			
c. Kostoja operacionale/prodhimi total	lekë/m <sup>3</sup>			
d. norma e popullatës së lidhur me sistemin e furnizimit me ujë	%			
e. Humbjet në ujë (të pajustificuara)	%			
f. Orët mesatare të furnizimit, urbane	h/d			
g. Norma e lidhjeve në kanalizimet e centralizuara, urbane	%			
h. Nr. i personelit (uji dhe ujërat e zeza)	nr			
i. Nr. i klientëve	nr			
j. Nr. i klientëve me matës të instaluar	nr			
k. Shuma e faturuar në periudhën e raportimit, ujë	lekë			
l. Shuma e faturuar në periudhën e raportimit, kanalizime	lekë			
m. Shuma e arkëtuar në periudhën e raportimit, ujë	lekë			
n. Shuma e arkëtuar në periudhën e raportimit, kanalizime	lekë			
o. Efikasiteti i arkëtimit (faturuar/arkëtuar)	%			

	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
<b>I.a Të ardhura nga tarifat për m<sup>3</sup></b> (në lekë/m <sup>3</sup> pa TVSH)							
- Ujë							
Ekonomi shtëpiake							
Institucione							
Biznesi							
- Kanalizime							
Ekonomi shtëpiake							
Institucione							
Biznesi							
<b>I.a Të ardhura nga tarifat e ujit në total</b>							
<b>I.a Të ardhura nga tarifat e kanalizimeve në total</b>							
<b>I.b Të ardhura të tjera</b>							
I.a+b Të ardhura totale							
<b>II. Kontribute (në lekë)</b>							
- Nga bashkia							
- Nga ministria përgjegjëse							
<b>III. Përballeshmëria</b>							
- Konsumi mesatar për ekonomi shtëpiake merret 90 lcd (në m <sup>3</sup> )							
- Fatura mesatare për ekonomitë shtëpiake për ujin dhe kanalizimet (në lekë përfshirë TVSH)							
- Të ardhurat e ekonomive shtëpiake sipas nivelit kombëtar të varfërisë (INSTAT) - Raporti i të ardhurave të ekonomive shtëpiake të varfra, i shpenzuar për ujin dhe kanalizimet							



**Ministria e Punëve Publike dhe Transportit**

Sheshi Skënderbej, nr. 5

Tiranë

Shqipëri

Corinna Engel

Referenca jonë: Eng

Tel. +49 (0) 69 7431 2594

E-mail: [corinna.engel@kfw.de](mailto:corinna.engel@kfw.de)

Data: (të plotësohet)

LE a4 Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë

Programi “Infrastruktura bashkiake II”,

12 milionë euro (Huaja A)

BMZ-Nr. 2010 65 705

2 milionë euro (Huaja B)

BMZ-Nr 2010 66 315

20, 482, 000 euro (Kontributi financiar)

BMZ-Nr 2020 60 408 dhe BMZ-Nr 2020 60 242

Marrëveshje e veçantë për marrëveshjen e huas A të datës 20 mars 2012

për marrëveshjen e huas B të datës 20 mars 2012

dhe për marrëveshjen e financimit mbi kontributin financiar të dhënë nga Bashkimi Europian i datës 20 mars 2012

Të nderuar zotërinj,

Ne i referohemi programit të infrastrukturës bashkiake II të KfW-së për furnizimin me ujë dhe kanalizimet për qytetet e Beratit, Fierit, Kamzës, Kuçovës, Lushnjës dhe Sarandës (Programi) dhe Marrëveshjes përkatëse të Huas të datës 20 mars 2012 (Marrëveshja e huas A) prej 12 milionë euro (Huaja A), marrëveshjes së huas të datës 20 mars 2012 (Marrëveshja e huas B) prej 2 milionë euro (Huaja B) ndërmjet KfW-së dhe Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave (Huamarrësi) dhe marrëveshjes së financimit prej 20, 482, 000 euro të lidhur ndërmjet KfW-së dhe Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave (Përfituesi) të 20 marsit 2012.

Marrëveshjet e sipërpërmendura janë të njohura për secilën prej UK Berat-Kuçovë, UK Fier, departamenti i ujit të bashkisë së Kamzës, UK Lushnja dhe UK Saranda që veprojnë si agjenci për zbatimin e projektit (së bashku “Agjencitë e zbatimit të projektit”, secila “Agjenci e zbatimit të projektit”, PEA) të Programit dhe zbatimin e tij në çdo qytet përkatës (secili “Nënprojekt”). Secila prej agjencive të zbatimit të projektit bie dakord për marrëveshjen e sipërpërmendur të huas A dhe B dhe marrëveshjen e financimit dhe në veçanti e njëjtin rol dhe si agjenci e zbatimit të projektit në lidhje me nënprojektin dhe bie dakord të marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet përkatëse dhe të përmbushë rregullisht të gjitha detyrimet sipas marrëveshjes së huas A dhe B dhe marrëveshjes së financimit në lidhje me programin, siç specifikohet më tej në marrëveshjen e huas A dhe B dhe marrëveshjen e financimit, siç specifikohet këtu më tej. Në pajtim me marrëveshjen e huas A dhe B dhe marrëveshjen e financimit, sa më poshtë përcaktohet me marrëveshje të veçantë:

Në pajtim me nenin 1.2 të marrëveshjes së huas A dhe B dhe marrëveshjen e financimit:

Hollësitë e programit si dhe mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga huaja;

Në pajtim me nenin 3.4 të marrëveshjes së huas A, nenin 3.1 të marrëveshjes së huas B dhe nenin 2.1 të marrëveshjes së financimit:

Procedurën e disbursimit, veçanërisht të dhënat që provojnë se shumatat e disbursuara të huas janë përdorur për qëllimet e përcaktuara;

Në pajtim me nenin 11.2 të marrëveshjes së huas A, nenin 8.2 të marrëveshjes së huas B dhe nenin 7.2 të marrëveshjes së financimit:

Hollësitë që u përkasin neneve të sipërpërmendur në lidhje me zbatimin e programit dhe informacionin e veçantë.

Ne propozojmë të bihet dakord sa më poshtë:

I. Projektimi i programit

1. Hollësitë e programit

Programi ka të bëjë me përmirësimin e sistemit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në bashki të zgjedhura të Shqipërisë, që janë bashkitë e Beratit, Fierit, Kamzës, Kuçovës, Lushnjës dhe Sarandës. Ky program i infrastrukturës bashkiake II pason programin e infrastrukturës bashkiake I të KfW-së. Qëllimi i programit është të sigurojë furnizim të qëndrueshëm dhe higjenikisht të sigurt për popullatën e qyteteve të programit me mbulim të shpenzimeve dhe tarifa shoqërisht të përballueshme, si dhe të sigurojë higjienë të përshtatshme nëpërmjet shkarkimit të ujërave të zeza. Kjo do të kontribuojë për një përdorim të efektshëm të burimeve ujore dhe për mbrojtjen e mjedisit me përmirësim paralel të kushteve të jetesës, punës dhe shëndetit të popullsisë. Kriteret për arritjen e këtyre objektivave, rezultatet e programit dhe aktivitetet e kërkuara të programit, si dhe supozimet në mbështetje të qëllimit të programit dhe rezultatet e programit gjenden në aneksin 1.

Projektimi i programit bazohet në analizën institucionale të MACS GmbH të qershorit 2010 dhe studimet e parafizibilitetit nga Kocks Consult dhe White Young Green Consult të tetorit 2011 në dispozicion të KfW-së, Huamarrësit, Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, që vepron si njësi e zbatimit të programit (“Njësia e zbatimit të programit”, PIU) dhe ndërmarrjeve të ujit dhe përkatësisht departamentit të ujit të Kamzës (“Agjencitë e zbatimit të programit”) dhe në marrëveshjet ndërmjet KfW-së, Huamarrësit, njësisë së zbatimit të programit dhe agjencive të zbatimit të programit gjatë vlerësimit të programit lokal në nëntor/dhjetor 2010, të përcaktuar në procesverbalin e mbledhjes të datës 2 dhjetor 2010.

Aktivitetet e mëposhtme të programit financohen nga huaja A dhe B dhe/ose kontributi financiar:

Berati dhe Kuçova:

- Prokurimi dhe instalimi i matësve të ujit;
- Zëvendësimi i pjesshëm i tubacionit të transmetimit nga Bugova në Berat dhe zëvendësimi i rrjetit të shpërndarjes në fshatra;
- Zëvendësimi i rrjetit të shpërndarjes në qendër të Beratit dhe në Kuçovë;
- Ndërtimi i tubacionit të transmetimit nga rezervuari i Koksit në rezervuarin e Drizës;
- Pajisjet operacionale (kalibrimi i matësve të ujit, etj.);
- Lidhjet e reja të fshatrave me rezervuarin e Drizës;
- Rrethimi i impiantit të trajtimit të ardhshëm të ujërave të zeza (WWTP);
- Ndërtesa e operacioneve.

Fier:

- Lidhja e Levanit dhe Frakullit nëpërmjet tubacionit të veçantë të transmetimit, duke përfshirë kapacitetin shtesë të rezervuarit dhe pompat e reja të pusit;
- Rrethimi në të ardhmen i zonës WWTP;
- Rehabilitimi i rrjetit ekzistues të kanalizimeve në qendër të qytetit dhe/ose zgjerimi i rrjetit të kanalizimeve në zonat perëndimore, në varësi të rezultateve të inspektimit CCTV.

Kamza:

- Prokurimi dhe instalimi i matësve të ujit për ekonominë shtëpiake;
- Tubacioni i transmetimit (nga rezervuari i ujit WTP);
- Impianti i trajtimit të ujit;
- Rezervuari;
- Rrjeti i shpërndarjes, instalimi i lidhjeve të reja;
- Pajisja operacionale për shkarkimin e ujit dhe kanalizimet (identifikimi i humbjeve etj).

Lushnja:



- Zëvendësimi i rrjetit të shpërndarjes në zonën e qytetit;
- Matësit shtesë të ujit;
- Rrethimi i zonës së WWTP-së në të ardhmen;
- Pajisjet operacionale;
- Ndërtesa e operacioneve, duke përfshirë ruajtjen dhe punishtet.

Saranda:

- Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjeteve të shpërndarjes së ujit në Sarandë;
- Pajisjet operacionale të matësve të ujit me shumicë, duke përfshirë ndërtesën operacionale të jashtme.

## 2. Grafiku kohor

Grafiku përkatës kohor për përgatitjen, zbatimin dhe operimin e programit gjendet në aneksin 2.

## 3. Kostoja totale dhe financimi

Kostoja totale e llogaritur e programit (kostoja totale) që mbështet vlerësimin e programit është rreth 34.5 milionë euro. Shuma e huas është 12 milionë euro për huanë A dhe 2 milionë euro për huanë B për të financuar investimet në vendndodhjet e programit në Berat, Fier, Kamzë, Kuçovë, Lushnjë dhe Sarandë. Përveç kësaj, ka edhe një grand të BE-së (Kontributi financiar) në shumën totale prej 20. 482. 000 euro. Parashikohet nën Instrumentin e Paraaderimit 2009 (IPA 2009) prej 5.39 milionë euro dhe sipas IPA 2010 prej 15.092 milionë euro që ndërmjet zërave të tjerë do të përfshijë veçanërisht shërbimet e konsulencës. Përbërja e koston totale dhe plani i financimit gjenden në aneksin 3.

## 4. Ndryshimet në projektimin e programit

Çdo ndryshim thelbësor në projektimin e programit kërkon pëlqimin paraprak të KfW-së dhe të Huamarrësit/përfituesit. Njësia e zbatimit të programit dhe/ose agjencitë e zbatimit të projektit njoftojnë menjëherë për këtë KfW-në, duke përcaktuar shkaqet, masat e planifikuara dhe pasojat e ndryshimit (duke përfshirë koston totale). Ekzekutimi i këtyre masave mund të fillojë vetëm mbi bazën e planifikimit të rishikuar dhe me pëlqimin e KfW-së.

Studimi i fizibilitetit që duhet të përditësohet kërkon pëlqimin e ndërsjellë të KfW-së, PIU-t dhe bashkisë së Kamzës para disbursimit të parë për nënprojektin e Kamzës.

## II. Zbatimi i programit

### 1. Përgjegjësitë dhe grafiku i kohës, koston dhe financimit

1.1 Ministria e Punëve Publike dhe Transportit është përgjegjëse për zbatimin e programit. Brenda këtij institucioni do të emërohet personeli në Drejtorinë e Përgjithshme për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet (GDWSS) për të formuar njësinë e zbatimit të programit (PIU). Ndërmarrjet e ujit pjesërisht në pronësi të bashkive përkatëse janë përgjegjëse për zbatimin dhe operimin e nënprojekteve të veçantë nën mbikëqyrjen e PIU-t. Të gjitha palët bashkëpunojnë ngushtësisht gjatë përgatitjes dhe zbatimit të programit dhe përcaktojnë me marrëveshje të përbashkët aspektet e programit që janë thelbësore për operimin e tij.

1.2 Grafiku i detajuar i kohës, koston dhe financimit, i përditësuar rregullisht për zbatimin e duhur teknik dhe financiar të programit, përgatitet sa më shpejt të jetë e mundur nga njësia e zbatimit të programit në bashkëpunim me konsulentin dhe i paraqitet KfW-së. Ky grafik duhet të tregojë, me afate dhe shuma, ndërlidhjen kronologjike të aktiviteteve të programit dhe kërkesat financiare rezultuese. Nëse një shmangie nga ky grafik bëhet i nevojshëm gjatë zbatimit të programit, KfW-së i jepet një grafik i rishikuar.

### 2. Caktimi i një konsulenti

2.1 Bazuar në dokumentacionin e disponueshëm, ndërmarrjet e ujit të Berat-Kuçovës, Fierit, Lushnjës dhe Sarandës dhe departamenti i ujit në bashkinë e Kamzës me asistencën e konsulentit të zbatimit (konsulenti i zbatimit) do të kryejnë një projektim të hollësishëm, përpilojnë dokumentet e

tenderit dhe prokurojnë mallrat dhe shërbimet. Konsulenti i zbatimit asiston ndërmarrjet e ujit në mbikëqyrjen e punëve të ndërtimit dhe periudhën e përgjegjësisë për defektet. Konsulenti i zbatimit kontraktohet nga njësia e zbatimit të programit. Në rast se shumica e kontratës së konsulentit kalon në nivel të konsiderueshëm buxhetin sipas aneksit 3, Huamarrësi duhet të aprovojë buxhetin e rishikuar.

2.2 Për masat institucionale në Lushnjë, Kamzë dhe Sarandë angazhohet një konsulent institucional (konsulent institucional) për të mbështetur ndërmarrjet në uljen e humbjeve administrative dhe në rishikimin e tarifave dhe planeve të biznesit për të përmirësuar situatën e tyre të të ardhurave në mënyrë të konsiderueshme (për t'u financuar nga kontributi financiar). Ky konsulent institucional do të kontraktohet nga njësia e zbatimit të programit.

2.3 Pas parapërzgjedhjes dhe ofertimit konkurrues ndërkombëtare publik, detyrat (për konsulentin e zbatimit dhe konsulentin institucional) jepen në kontrata të veçanta për shoqëritë e pavarura të kualifikuara konsulente. Procedura për dhënien e kontratës rregullohet nga “Udhëzimet për caktimin e konsulentëve në bashkëpunimin financiar me vendet në zhvillim” (aneksi 4) që përbën pjesë integrale të kësaj. Dokumentet e tenderit do të përfshijnë një deklaratë që përshtatshmëria e ofertuesve, ndërmjet faktorëve të tjerë, do t'i nënshtrohet verifikimit nga Bashkimi Europian (BE) bazuar në sistemin e brendshëm të BE-së për paralajmërimin paraprak.

2.4 Në njoftimin e parakualifikimit ose-nëse nuk kryhet parakualifikim-në ftesën për tenderë, njësia e zbatimit të programit i detyron ofertuesit të paraqesin së bashku me dokumentet e tenderit ose së bashku me ofertën, një deklaratë angazhimi të nënshkruar sipas rregullave (aneksi 4, faqe 16).

2.5 Njësia e zbatimit të programit i kërkon KfW-së të autorizojë një ekspert (agjent tenderi) të asistojë njësinë e zbatimit të programit në zgjedhjen dhe kontraktimin e konsulentit të zbatimit dhe konsulentin institucional. Specifikisht, agjenti i tenderit asiston njësinë e zbatimit të programit me shërbimet e mëposhtme:

- Hartimin e termave të referencës për shërbimet e konsulencës, duke përfshirë një projekt kontratë konsulence (kontratë standarde konsulence e KfW-së);
- Përmbushjen e parakualifikimit dhe “renditjen paraprake” për ofertuesit e kualifikuar;
- Kryerjen e tenderit, duke përfshirë propozimin e arsyetuar për dhënien e kontratës;
- Paraqitjen e një projekt kontrate konsulence që është negociuar me konsulentët.

Kostoja e shkaktuar për agjentin e tenderit mbulohet nga një grand i veçantë që jepet për këtë qëllim nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).

2.6 Brenda dy javëve pasi njësia e zbatimit të programit dhe KfW-ja të kenë marrë propozimet e agjentit të tenderit në lidhje me termat e referencës, propozimet dhe dhënien e kontratave dhe projekt kontratat e konsulencës, ata do t'i komentojnë ato.

### 3. Dhënia e kontratave për mallrat dhe shërbimet e tjera

3.1 Kontratat për mallrat dhe të gjitha shërbimet e tjera do të jepen në bashkëpunim me konsulentin e zbatimit nëpërmjet ofertimit konkurrues ndërkombëtar.

3.2 Dokumentet e tenderit i paraqiten KfW-së për koment në kohën e duhur para publikimit të ftesës për tender. Dokumentet e tenderit do të përfshijnë një deklaram që përshtatshmëria e ofertuesve, ndërmjet të tjerave, do t'i nënshtrohen verifikimit të Bashkimit Europian (BE) bazuar në sistemin e brendshëm të BE-së për paralajmërimin paraprak.

3.3 Periudha e ofertimit përcaktohet në një mënyrë të tillë që t'u mundësojë ofertuesve kohë të mjaftueshme për të përgatitur ofertat e tyre.

3.4 Hollësitë e mbetura në lidhje me procedurën e dhënies dhe dispozitat kontraktuale janë të shpjeguara tek “Udhëzimet për prokurimin e furnizimit dhe kontratat e punës sipas bashkëpunimit financiar me vendet në zhvillim” (aneksi 5), që përbën pjesë integrale të kësaj marrëveshjeje.

3.5 Në njoftimin e parakualifikimit – ose nëse nuk kryhet parakualifikim – në dokumentet e tenderit, agjencitë e zbatimit të programit ose njësia e zbatimit të programit në rastin e shërbimeve të





konsulencës përkatësisht i detyron ofertuesit të paraqesin së bashku me dokumentet e para-kualifikimit ose së bashku me ofertën një deklaratë angazhimi (aneksi 5, faqe 27).

3.6 Gjatë lidhjes së kontratave për mallrat dhe shërbimet që financohen nga huaja, agjencitë e zbatimit të programit respektojnë gjithashtu parimet e mëposhtme:

a) Meqenëse nga huaja nuk mund të financohen detyrimet e importit në pajtim me nenin 1.3 të marrëveshjes së huas, këto detyrime importi, nëse janë pjesë e vlerës së kontratës, përcaktohen veçmas në kontratat për mallrat dhe shërbimet në fatura.

b) Nëse pagesat e kërkueshme sipas kontratave për shërbimet dhe mallrat duhet të bëhen nga huaja, këto kontrata përfshijnë një dispozitë që parashikon që çdo rimbursim, garanci ose pagesë tjetër e kërkueshme dhe çdo pagesë siguracioni bëhet për llogari të Huamarrësit në llogarinë nr 38 000 000 00 (IBAN DE53 5002 0400 3800 0000 00) tek KfW-ja, Frankfurt am Main (BIC: KFWIDEFF; BLZ 500 204 00), ku KfW-ja i krediton këto pagesa në llogarinë e Huamarrësit. Nëse këto pagesa bëhen në monedhën lokale, ato dërgohen te një llogari e veçantë e agjencisë së zbatimit të programit, në vendin e agjencisë së zbatimit të programit, që mund të tërhiqet vetëm me pëlqimin e KfW-së. Këto fonde mund të ripërdoren për ekzekutimin e programit me pëlqimin e KfW-së.

3.7 Para lidhjes së kontratës për mallrat dhe shërbimet, KfW-së i jepet për koment projekt-kontrata e rënë dakord, e pajisur rregullisht me miratimin e konsulentit të zbatimit. Kjo zbatohet edhe për çdo marrëveshje pasuese modifikuese ose ndryshuese.

#### 4. Marrëveshjet e veçanta të zbatimit

4.1 Para kontraktimit të shërbimeve të konsulentit të zbatimit, detyrat e mëposhtme duhet të përmbushen nga ndërmarrjet e ujit: Një koncept për përshtatjen e tarifave dhe mbulimin e shpenzimeve zhvillohet ose përditësohet përkatësisht dhe aprovohet nga bordi mbikëqyrës i ndërmarrjeve të ujit dhe i paraqitet rregullatorit (ERRU).

4.2 Para tenderimit të mallrave dhe shërbimeve të tjera, një audit i jashtëm ka certifikuar që UK Berat-Kuçova ka arritur 80% të mbulimit të kostos duke përfshirë shërbimin e borxhit, UK Fier ka arritur 90% të mbulimit të kostos duke përfshirë shërbimin e borxhit (përveç tenderit të matësve të jashtëm të ujit), departamenti i ujit i bashkisë së Kamzës ka arritur 55% të mbulimit të kostos, UK Lushnja ka arritur 65% të mbulimit të kostos dhe UK Saranda ka arritur 70% të mbulimit të kostos.

4.3 Para kontraktimit të mallrave dhe shërbimeve, është aprovuar një propozim për rritjen e tarifës nga bashkitë përkatëse dhe i është paraqitur rregullatorit (ERRU) që tregon qartësisht se UK Berat-Kuçova mund të arrijë 100% të mbulimit të kostos duke përfshirë shërbimin e borxhit në vitin pasues, UK Fier mund të arrijë 95% të mbulimit të kostos duke përfshirë shërbimin e borxhit (përveç tenderit për matësit e jashtëm të ujit) në vitin pasues, departamenti i ujit i bashkisë së Kamzës mund të arrijë 100% të mbulimit të kostos në vitin pasues, UK Lushnja mund të arrijë 75% të mbulimit të kostos në vitin pasues dhe UK Saranda mund të arrijë 90% të mbulimit të kostos në vitin pasues.

4.4 Për më tepër ndërmarrjet e ujit do të zbatojnë masat e mëposhtme, me qëllim që të ngrenë normën e mbulimit të kostos:

##### Berat – Kuçova:

- Rritje e tarifës vjetore në furnizimin me ujë dhe kanalizimet për ekonomitë shtëpiake /shoqëritë private/institucionet publike me të paktën 20%/10%/10% në vitin 2012 dhe në vitin 2013,
- Rritje e vazhdueshme e tarifës vjetore për furnizimin me ujë dhe kanalizime për të gjithë grupet e klientëve me të paktën 2%, duke filluar në vitin 2014;
- Efikasitet i përmirësuar i faturimit dhe efijencë e stabilizuar në arkëtime.

##### Fier:

- Rritje e tarifës vjetore në furnizimin me ujë me të paktën 16%/6%/10% për ekonomitë shtëpiake /shoqëritë private /institucionet publike në vitin 2012 dhe në vitin 2013,

- Rritje vjetore e tarifës për kanalizimet për ekonomitë shtëpiake/shoqëritë private/institucionet publike me të paktën 35% /18% /25% në secilin prej dy viteve në vazhdim;
- Rritje e vazhdueshme e tarifës vjetore për furnizimin me ujë dhe kanalizime për të gjithë grupet e klientëve me të paktën 5%, duke filluar në vitin 2014;
- Efikasitet i përmirësuar arkëtimi në të paktën 85 %;
- Efikasitet i përmirësuar i faturimit dhe llogarimbajtje dhe komunikimi me klientët;
- Instalim i të paktën 25 000 matësve të ujit.

**Kamëz:**

- Rritje e tarifës vjetore në furnizimin me ujë dhe kanalizimet për ekonomitë shtëpiake me të paktën 5% në vitin 2012, në vitin 2013 dhe në vitin 2014 dhe rritje e mëtejshme e tarifës sapo të jetë rritur norma e lidhjes;
- Sistem transparent për llogarimbajtjen në lidhje me ujin dhe kanalizimet që është e ndarë brenda administratës bashkiake;
- Stabilizimi i efijences së arkëtimeve;
- Efikasitet i përmirësuar i faturimit dhe llogari- mbajtje dhe komunikim me klientët.

**Lushnjë:**

- Rritje e tarifës vjetore në furnizimin me ujë për ekonomitë shtëpiake/shoqëritë private/institucionet publike me të paktën 20% /15% /10% në vitin 2012, në vitin 2013 dhe në vitin 2014;
- Rritje vjetore e tarifës për kanalizimet për ekonomitë shtëpiake me të paktën 10% në vitin 2012, në vitin 2013 dhe në vitin 2014;
- Rritje e vazhdueshme e tarifës vjetore për furnizimin me ujë dhe kanalizime për të gjitha grupet e klientëve me të paktën 5%, duke filluar në vitin 2015;
- Efikasitet i përmirësuar në faturim dhe arkëtim.

**Sarandë:**

- Rritje vjetore e tarifës për furnizimin me ujë prej të paktën 15% për ekonomitë shtëpiake dhe të paktën 10% për shoqëritë private dhe institucionet publike në vitin 2012, në vitin 2013 dhe në vitin 2014;
- Rritje e vazhdueshme e tarifës vjetore për furnizimin me ujë për të gjithë grupet e klientëve me të paktën 5%, duke filluar në vitin 2015;
- Normë e përmirësuar e faturimit dhe arkëtitimit, veçanërisht për turistët sezonalë dhe fshatrat rrethues, që tarifohen për furnizim me shumicë.

4.5 Ministria e Punëve Publike dhe Transportit siguron fondet për rimbursimin e TVSH-së dhe detyrimeve doganore nga buxheti i tyre vjetor.

**5. Dispozitat për operimin e duhur të programit**

5.1 Për të siguruar operimin e duhur të programit, njësia e zbatimit të programit paraqet një koncept operimi dhe mirëmbajtjeje të përpiluar në bashkëpunim me ndërmarrjet e ujit dhe konsulentin e zbatimit të paktën gjashtë muaj para autorizimit të investimit sipas programit.

5.2 Në të njëjtën kohë, agjencitë e zbatimit të programit i paraqesin KfW-së një parashikim financiar të përpiluar në pajtim me konsulentin e zbatimit për zonën e operimit në të cilin ndodhen nënprojektet. Ky parashikim duhet të tregojë që financimi për operimin është i siguruar. Agjencitë e zbatimit të programit përditësojnë periodikisht këtë parashikim dhe sigurojnë që çdo boshllëk financiar të mbulohet në kohën e duhur. Agjencitë e zbatimit të programit ia transmetojnë KfW-së pa vonesë këtë parashikim financiar, si dhe versionet e tij të rishikuara.

**6. Caktimi i një auditi**

6.1 Një audit vjetor për përdorimin e kontributit financiar të dhënë nga Bashkimi Europian (Audit) kryhet sipas këtij programi. KfW-ja dhe Ministria e Financave rishikojnë nëse auditi mund të kryhet nga auditi i përzgjedhur nga Ministria e Financave.



6.2 Auditimi përzgjidhet pas ofrimit konkurrues ndërkombëtar dhe certifikon çdo vit përdorimin e duhur të kontributit financiar të dhënë nga Bashkimi Europian deri në përfundimin e programit.

6.3 Auditimi i kontributit financiar të dhënë nga Bashkimi Europian do të financohet nga kontributi financiar.

6.4 Termet e referencës për auditin do të bazohen në termat standarde të referencës së KfW-së që do t'i paraqiten KfW-së para caktimit të auditit.

### III. Lista e mallrave dhe shërbimeve dhe procedura e disbursimit

#### 1. Lista e mallrave dhe shërbimeve

1.1 Lista e mallrave dhe shërbimeve që do të financohen nga huaja përgatitet në bazë të kontratave të lidhura për këto mallra dhe shërbime. Përkatësisht, KfW-së i jepet një kopje origjinale ose e thjeshtë e secilës prej kontratave të lartpërmendura dhe e çdo kontrate përkatëse ndryshuese.

1.2 Nëse një masë e programit duhet të zbatohet pa marrëveshje dhe nuk janë lidhur kontratat, KfW-ja, në mungesë të kontratave, merr një grafik të masave të planifikuara, të ndara në kategoritë kryesore të kostos (grafik i masave pa kontratë). Kostoja e shkaktuar për administrimin e përgjithshëm në lidhje me punën pa kontratë nuk duhet të përfshihet në këtë grafik të masave pa kontratë.

1.3 KfW-ja njofton njësinë e zbatimit të programit me kërkesë për shumat e Huas që ka rezervuar për financim (lista e mallrave dhe shërbimeve).

#### 2. Procedura e disbursimit

Disbursimi rregullohet nga rregulloret sipas parashikimit në aneksin 6 (procedura e disbursimit) që përbën pjesë integrale të kësaj marrëveshjeje.

Kontributi financiar i dhënë nga Bashkimi Europian do të përdoret për të financuar kontratat për konsultim, mallra dhe shërbime që janë dhënë pas ofertimit konkurrues ndërkombëtar për nënprojektet në Berat –Kuçovë, Fier, Kamzë, Lushnjë dhe Sarandë.

Të gjitha shërbimet e konsulencës do të financohen ekskluzivisht nga fondet e BE-së. Pagesat sipas kontratave për mallrat dhe shërbimet do të disbursohen proporcionalisht nga Kontributi Financiar i dhënë nga Bashkimi Europian the huaja A dhe B e dhënë sipas Bashkëpunimit Financiar Gjerman për këto kontrata.

Sipas ndarjes në aneksin 3, financimi i BE-së për Kamzën i referohet BMZ-nr. 2020 60 242, financimi i BE-së për Berat-Kuçovën, Fierin, Lushnjën dhe Sarandën i referohet BMZ-nr. 2020 60 408.

### IV. Raportimi dhe dispozita të tjera

#### 1. Raportimi

1.1 Deri në një njoftim të dytë, njësia e zbatimit të programit i raporton KfW-së në çdo semestër mbi përparimin e programit (raporte progresi) dhe të marrëveshjeve të zbatimit të parashikuara në seksionin II.4 të kësaj Marrëveshjeje dhe mbi zhvillimin e të gjitha kushteve të tjera të përgjithshme të rëndësishme. Raporti përfshin pikat e renditura në aneksin 7. Përveç kësaj, njësia e zbatimit të programit raporton për të gjitha rrethanat që mund të rrezikojnë arritjen e objektivit të përgjithshëm, qëllimit të programit dhe rezultateve. Në momentin e përfundimit fizik dhe autorizimit të programit, por jo më vonë se mbarimi i periudhës së garancisë, njësia e zbatimit të programit paraqet një raport përfundimtar mbi masat e përmbushura. Raportet kërkohen në ditën e fundit të muajit pas çdo semestri viti (31 janar, 30 prill, 31 korrik dhe 31 tetor). Raporti i parë është i kërkueshëm më 31 korrik 2012. Raportet siglohen nga konsulenti.

1.2 Nëse njësia e zbatimit të programit ka ngarkuar konsulentin të përpilojë raportet e progresit dhe/ose raportin përfundimtar, njësia e zbatimit të programit komenton mbi raportet ose një aprovimin e përmbajtjes së tij duke sigluar raportet.

1.3 Pas përfundimit të programit, njësia e zbatimit të programit raporton mbi zhvillimin e tij të mëtejshëm (shihni aneksin 7 për hollësi). KfW-ja informon rregullisht njësinë e zbatimit të programit në lidhje me përfundimin e periudhës së raportimit.

## 2. Dispozita të tjera

2.1 Njësia e zbatimit të programit dhe agjencitë e zbatimit të projektit i dërgojnë KfW-së ato dokumente që janë të nevojshme për KfW-në të bëjë komente dhe aprovimet e përmendura më sipër ose në udhëzimet e bashkëlidhura, brenda një kohe të mjaftueshme për t'i dhënë mundësi të arsyeshme për shqyrtim.

2.2 Huamarrësi vendos tabela programi që përmbajnë të paktën mesazhin e mëposhtëm:

“Një projekt zhvillimi i Qeverisë së Shqipërisë, i bashkëfinancuar nga Bashkimi Europian dhe Republika Federale Gjermane nëpërmjet KfW-së”.

Një vulë programi e dhënë nga Ambasada Gjermane dhe logoja e Bashkimit Europian (dymbëdhjetë yje të verdhë në një sfond blu) vendoset në tabelën e programit.

2.3 Të gjitha automjetet dhe pajisjet e prokuruar nga konsulentët për programin do të transferohen te njësia e zbatimit të programit pas përfundimit të programit. Prova dokumentuese për transferimin mbahet nga njësia e zbatimit të programit deri pesë vjet pas përfundimit të programit.

2.4 Njësia e zbatimit të programit siguron që të gjithë dokumentet e përgatitura nga konsulentët të përfshijnë një referencë ndaj faktit që programi të bashkëfinancohet nga Bashkimi Europian dhe të shfaqë logon europiane (dymbëdhjetë yje të verdhë në sfond blu). Kjo zbatohet edhe për automjetet dhe pajisjet që janë prokuruar nga konsulenti për programin derisa të transferohen te njësia e zbatimit të programit pas përfundimit të programit.

2.5 Njësia e zbatimit të programit do të publikojë hollësitë e mëposhtme për të gjitha kontratat që financohen sipas kësaj marrëveshjeje në faqen e saj të internetit: titullin dhe tipin e kontratës, adresën dhe shtetësinë e kontraktorit, shumën e kontratës.

2.6 Njësia e zbatimit të programit siguron që i gjithë dokumentacioni në lidhje me përgatitjen dhe zbatimin e programit të jetë i disponueshëm për auditim për të paktën pesë vjet pas përfundimit të programit. Njësia e zbatimit të programit siguron gjithashtu që Komisioni Europian ose përfaqësuesit e tij të jenë në gjendje të kryejnë vlerësime të programit para, gjatë ose pas përfundimit të tij.

2.7 Dispozitat e kësaj marrëveshjeje të veçantë mund të ndryshohen ose modifikohen me marrëveshje të përbashkët me shkrim të të gjithë nënshkruesve të kësaj marrëveshjeje të veçantë, përveç kur ky ndryshim ose modifikim ka të bëjë me një bashki ose agjenci zbatimi të projektit, rast në të cilin ky ndryshim duhet të bëhet vetëm me marrëveshje të përbashkët me shkrim ndërmjet njësisë së zbatimit të programit, KfW-së dhe agjencisë së zbatimit të programit përkatës.

2.8 Secila prej agjencive të zbatimit të projektit i ofron menjëherë KfW-së, me kërkesë, të gjithë informacionin dhe dokumentet që KfW-ja kërkon për të mbushur detyrimet e saj për të parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të raportit të biznesit me agjencinë e zbatimit të projektit, që është i nevojshëm për këtë qëllim.

Gjatë lidhjes dhe zbatimit të marrëveshjes së huas A, B ose marrëveshjes së financimit, përkatësisht, secila agjenci e zbatimit të projektit vepron në emër të saj dhe për llogari të saj. Në lidhje me ligjin gjerman dhe ligjin e vendit të themelimit të agjencisë së zbatimit të projektit:

a) asnjë prej burimeve ose shumave të agjencisë së zbatimit të projektit të investuara në financimin e projektit nuk është me origjinë të paligjshme dhe, veçanërisht, kjo listë nuk është shteruese, nuk lidhet me trafikimin e drogës, korrupsionin, aktivitetin e krimit të organizuar ose terrorizmin;

b) kapitali i secilës prej agjencive të zbatimit të projektit në asnjë rast nuk është me origjinë të paligjshme dhe, veçanërisht, kjo listë nuk është shteruese, nuk lidhet me trafikimin e drogës, korrupsionin, aktivitetin e krimit të organizuar ose terrorizmin;



c) asnjë prej agjencive të zbatimit të projektit nuk përfshihet në përfitim, zotërimin ose përdorimin e pasurive që janë me origjinë të paligjshme dhe veçanërisht, kjo listë nuk është shteruese, nuk lidhet me trafikimin e drogës, korrupsionin, aktivitetin e krimit të organizuar ose terrorizmin; dhe

d) asnjë prej agjencive të zbatimit të projektit nuk përfshihet në financimin e terrorizmit.

Jeni të lutur të konfirmoni pëlqimin tuaj për marrëveshjen e mësipërme, duke nënshkruar në një mënyrë ligjërishit detyruese dhe duke kthyer kopjet e bashkëlidhura.

Ne bashkëlidhim një kopje të kësaj letre me kërkesën për t'ua transmetuar në kohën e duhur bashkive të Beratit, Fierit, Kamzës, Kuçovës, Lushnjës dhe Sarandës.

Jeni të lutur gjithashtu të transmetoni një kopje të kësaj letre në kohën e duhur te konsulenti.

Me respekt

**KfW**

Nga	----	Nga	---
Emri	----	Emri	----
Titulli	----	Titulli	----

Lexuar dhe rënë dakord:

Tiranë, ----

**Republika e Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave (Huamarrësi)**

Nga	---
Emri	Ridvan Bode
Titulli	Ministër i Financave

**Ministria e Punëve Publike dhe Transportit**

Nga	---
Emri	Sokol Olldashi
Titulli	Ministër i Punëve Publike dhe Transportit

**Ndërmarrja e Ujit, Berat-Kuçovë**

Nga	----	Ndërmarrja e Ujit, Fier	
Nga	---	Nga	---
Emri	----	Emri	----
Titulli	----	Titulli	----

**Bashki Kamëz**

**Ndërmarrja e Ujit, Lushnjë**

Nga	----	Nga	---
Emri	----	Emri	----
Titulli	----	Titulli	----

**Ndërmarrja e Ujit, Sarandë**

Nga	----
Emri	----
Titulli	----

## ANEKSE

- Aneksi 1: Objektivat dhe rezultatet e programit dhe supozimet për arritjen e tyre
- Aneksi 2: Grafiku kohor
- Aneksi 3: Kostoja totale dhe financimi
- Aneksi 4: Udhëzime për caktimin e konsulentëve në bashkëpunimin financiar me vendet në zhvillim
- Aneksi 5: Udhëzime për prokurimin e kontratave të furnizimit dhe punëve sipas bashkëpunimit financiar me vendet në zhvillim
- Aneksi 6: Procedura e disbursimit
- Aneksi 7: Përmbajtja dhe forma e raportimit

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 30.4.2012  
Doli nga shtypi më 30.4.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2012

Çmimi 76 lekë